

RREGULLAT E AGJËRIMIT DHE FILOZOFIA E TIJ

MUSTAFA SIBAI

DR. MUSTAFA SIBAI

FILOZOFIA E AGJËRIMIT DHE RREGULLAT E TIJ

Botues: Logos-A

Shkup

1414/1994

HYRJE

I falënderohemi Zotit, Atij i mbështetemi dhe prej Tij kërkojmë mbrojtje nga dëmet e epsheve tona dhe nga veprat e këqija. Atë që e udhëzoi Zoti nuk humbë e atë që e humbë s'ka kush ta udhëzojë. Dëshmoj se s'ka zot tjetër pos Allahut xh. sh. dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij!

Muaji i Ramazanit është një nga periudhat më të rëndësishme prej periudhave të mirësisë sepse në të pastrohen shpirtat, afrohen zemrat ndaj Krijuesit të tyre, hapen dyert e parajsës, shtohet mirëbërja, i zbriti Kur'ani Famëlartë Muhammedit a.s., pejgamber si udhëzues për njerëzit, dallues mes të mirës e të keqes, udhërrëfyes kah mirësia dhe dallues i rrugëve të humbjes e të keqes... Zoti e bëri Kur'anin kushtetutë të përhershme deri në Ditën e gjykimit dhe ai që e përcjell atë shpëton ndërsa ai që i refuzon udhëzimet, dritën, lejimet dhe ndalesat e tij humbë jo vetëm në këtë botë por edhe në botën tjetër.

Zoti e obligoi agjërimin e Ramazanit, ia përshkroi vetes së Madhëruar, shpërblen agjëruesin, realizon premtimin dhe bujaria e Tij s'krahasonet me asgjë.

Që të pranohet vepra e mirë, njeriu duhet ta kuptojë çanësimin, parimet dhe rregullat, gjegjësisht nëse dëshiron të praktikojë mënyrën e drejtë sipas rregullave që i caktoi Allahu xh.sh. për robin e Tij me dëshirë të plotë e të lirë. Kjo gjë kushtëzohet me njohjen e ajeteve të shpallura dhe haditheve të Muhammedit a.s.

Dijetarët tanë prej të kaluarës së hershme e deri më tash janë orvatur t'i sqarojnë rregullat e agjërimit dhe obligimet tjera duke i paraqitur anët e shumta pazitive të tyre, Zoti i shpërbleftë të gjithë. Njëri prej dijetarëve të fundit është edhe Shejh Mustafa Siba'i (Zoti

e mëshiroftë) i cili shkroi një numër të madh artikujsh në të cilët ka diskutuar rreth rregullave të agjërit, ka komentuar disa ajete e hadithe të agjërit, ka ligjëruar rreth udhëzimeve të Muhammedit a.s., dy festave të bajrameve, sadakatul fitrit (kontribut i obligueshëm), zekatit, israsë, miraxhit etj.

Këta artikuj janë përmbledhur në këtë libër dhe kanë të bëjnë me këshillime e fikh edhe atë sipas metodës së tij të njohur (Zoti e shpërbleftë dhe e mëshiroftë).

Tash na u bë e mundur (me ndihmën e Zotit të Madhëruar) që t'ua ofrojmë lexuesve tanë këtë botim duke iu lutur Allahut xh.sh. ta pranojë këtë mund e ta shpërblejë autorin, të na i falë mëkatet tona e të tij dhe ky popull të ketë dobi nga trashëgimia e të parëve tanë si dhe të na rikthehet fama dhe autoriteti i humbur.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

BOTUESI

A thua vallë do të qëndronin në atë betejë të madhe, qoftë edhe disa ditë, sikur të ishin të formuar me shpirtat e pabesimtarëve që tallen me agjërimin e muslimanëve apo me shpirtat e të dështuarve që jetojnë nëpër bare e kafene të mbushura me alkool e që s'mund t'i përballojnë urisë dhe etjes disaorëshe? Jo vëllezër, sepse Islami i ka mësuar me anë të agjërimin në kohën e paqes si të agjërojnë në ditët e luftës... Në luftë nuk e fiton i dobëti të fortin, pakica shumicën, i paarmatosuri të armatosurin përpos nëse është i kalitur me moralin e agjëruësve...

Me këtë koncept preciz të lirisë dhe robërimit e presim Ramazanin si muaj të "lirisë" kurse agjërimin si shkollë ku diplomojnë të lirët me plotkuptimin shkencor të fjalës. Në Ramazan ka uri, etje, kufizim dhe ndalim, por edhe shëndet dhe lirim nga robërimi; në të ka revolucion kundër robërimit të ushqimit e pierjes, shprehisë e jetës monotone... Revolucionin kundër robërisë është atributi i parë i të lirëve.

PJESA E PARË

1. Ajetet e agjërimit
2. Hadithet e agjërimit
3. Hadithet e Bajramit
4. Udhëzimet e Muhammedit a.s. rreth agjërimit dhe dy bajrameve
5. Rregullat e agjërimit
6. Sadakatul-fitri (dhënia lëmoshë)

AJETET E AGJËRIMIT

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjëroj) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor) i një të varfëri e ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju. (Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramazanit, që në të (filloi të) shpallet Kur'ani që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra. E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë në ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim e jo ngarkim për ju. (T'i agjëroni ditët e lëshuara më vonë) që të plotësoni numrin, ta madhëroni Allahun për atë se ju udhëzoi dhe që ta falënderoni." (El- Bekare:183-185)

"Netëve të agjërimit u është lejuar afrimi te gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato. Allahu e di se ju e keni mashtruar vetveten, andaj ua pranoi pendimin dhe ua fali gabimin. Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkonin atë që ua ka caktuar Allahu dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësone deri në mbrëmje. E kur jeni të izoluar (në i'tikafë) në xhamia, mos iu afroni atyre (për marrëdhënie intime). Këto janë dispozitat e Allahut, pra mos i kundërshtoni. Ja kështu, në këtë mënyrë Allahu ua sqaron njerëzve argumentet e veta që ata të ruhen." (El-Bekare:187).

HADITHET E AGJËRIMIT

A. Vlera e agjërimit:

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kush agjëron Ramazanin me bindje dhe kënaqësi, i falen mëkatet e bëra." (Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi).

Transmetohet nga Ebu Se'id el-Hudrij se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kush e agjëron Ramazanin, i njeh rregullat e tij dhe mbrohet nga ajo që duhet të mbrohet, i falen mëkatet e bëra." (Bejheki dhe Ibn Hibban).

Transmetohet nga Xhabir ibn Abdil-lah se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Ummetit tim i janë dhuruar pesë gjëra në Muajin e Ramazanit të cilat nuk i janë dhënë asnjë të dërguari para meje.

Njëra prej tyre është se Zoti i Madhëruar i shikon ata në natën e parë të Ramazanit, e atë që e shikon Ai nuk e dënon asnjëherë.

E dyta është ajo se era e keqe e gojës së tyre në mbrëmje është më e mirë se aroma e miskut.

E treta është se engjëjt kërkojnë falje për ta çdo ditë e çdo natë.

E katërta, se Zoti i Madhëruar e urdhëron parajsën kështu: "Përgatitu dhe zbukurohu për robërit e Mi sepse është afuar dita e pushimit të tyre në shtëpinë dhe zemërgjerësinë time nga lodhjet e kësaj bote".

E pesta është se Zoti i Madhëruar i falë të gjithë natën e fundit.

Njëri prej të pranishmëve e pyeti: "A është Nata e Kadrit"? Ai u përgjigj: "Jo, a nuk sheh se punëtorët kur i kryejnë punët i marrin shpërblimet (rrogat)." (Bejheki).

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Pesë namazet, prej xhumasë në xhuma dhe prej Ramazanit në Ramazan falen (mëkatet) pos atyre që janë të mëdha (kebair)". (Muslimi).

Transmetohet nga Ka'b ibn Axhre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Zoti e largon nga mëshira e vet atë që e kalon Ramazanin pa u falur." (El-Hakimi). Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Çdo vepër e njeriut shtohet, e mira prej dhjetë deri në shtatëqind herë. Zoti i Madhëruar thotë: "Përveç agjërimit, sepse ai është për Mua dhe unë e shpërblej, sepse ai braktis kënaqësinë dhe ushqimin për Mua. Për agjëruesin ka dy gëzime: gëzimi i parë është në iftar kurse i dyti në takimin me Zotin e tij. Era e keqe nga goja e agjëruesit është më e mirë se Zoti se aroma e miskut." (Buhariu dhe Muslimi).

Transmetohet nga ibn Mes'ud el-Gaffari se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Sikur ta dinë njerëzit vlerën e Ramazanit, do të dëshironin të jetë i gjithë viti Ramazan." (Ibn Huzejme).

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Tre personave u pranohen lutjet: 1. Agjëruesit deri në iftar; 2. Udhëheqësit (prijësit) të drejtë; dhe 3. Lutja e të dëmtuarit (të keqtrajtuarit) ngrihet lartë, i hapen dyert e qiellit dhe Zoti i thotë: Pasha fuqinë time, do të ndihmoj, qoftë edhe pas një kohe." (Ahmedi dhe Tirmidhiu).

B. Nata e Kadrit

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kush ngrihet (lutet) Natën e Kadrit, me bindje e kënaqësi, i falen mëkatet e bëra." (Buhariu dhe Muslimi).

Transmetohet nga Enes Ibn Maliku se me ardhjen e Muajit të Ramazanit, Muhammedi a.s. ka thënë:

"U erdhi ky muaj, i cili ka vlerë më shumë se një mijë muaj e atij që i ndalohet, i është ndaluar gjithë mirësia. Të mirën e tij e refuzon vetëm i mallkuari." (Ibn Maxhe).

Transmetohet nga Ubade ibn Samit se Muhammedi a.s. për Natën e Kadrit ka thënë: "Kjo natë është në Ramazan, në dhjetë ditët e fundit, (gjegjesisht) në ditën e njëzet e një,

njëzet e tretë, njëzet e pestë, njëzet e shtatë, njëzet e nëntë ose natën e fundit. Kush lutet në atë natë me kënaqësi, i falen mëkatet e kaluara e të ardhshme." (Ahmedi).

C. Prishja e agjërimit të Ramazanit pa arsye

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kush e prishë një ditë agjërimi në Ramazan pa arsye e pa sëmurje, nuk mund ta kompensojë as me agjërim shekullor." (Tirmidhiu).

Ç. Lejimet e prishjes së agjërimit

Transmetohet nga Xhabiri se Muhammedi a.s. ka kaluar në Mekke në vitin e çlirimit edhe atë në Ramazan derisa ka arritur në vendin Kera'ë el-Gamim. Ai aty ka agjëruar së bashku me njerëzit tjerë pastaj ka kërkuar ujë, e ka ngritur lartë gotën derisa e kanë parë njerëzit dhe e ka pirë ujin. Kur është informuar se disa kanë

vazhduar agjërimin, ka thënë: "Ata janë mëkatarë, ata janë mëkatarë..." (Muslimi dhe Tirmidhiu).

Transmetohet nga Xhabiri se Muhammedi a.s. gjatë një udhëtimi të tij ka vërejtur një njeri rreth të cilit janë tubuar njerëz. Është afruar dhe i ka pyetur: "Ç'ka ai?" Ata i janë përgjigjur: "Agjëron", kurse Muhammedi a.s. atëherë u përgjigj: "Nuk është mirësi të agjëroni gjatë udhëtimit". (Buhariu dhe Muslimi).

Transmetohet nga Aisheja se Hamza ibn Amër el-Eslemij e ka pyetur Muhammedin a.s. për agjërimin në udhëtim (ka agjëruar shumë), kurse Muhammedi a.s. i është përgjigjur: "Nëse dëshiron agjëro, e nëse jo, atëherë ha." (Buhariu dhe Muslimi).

Transmetohet nga një njeri i Beni Abdil-las ibn Ka'ëb ibn Malikut, i quajtur Enes ibn Malik, se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Zoti i Madhëruar ia ka shkurtuar namazin udhëtarit dhe ia ka lejuar prishjen e agjërimit. Ai gjithashtu ia ka mundësuar gruas që i jep gjë fëmijës dhe asaj që është me barrë për shkak të mëshirës ndaj fëmijëve të saj." (Përmbledhësit e Suneneve).

Transmetohet nga Mua'dh ibn Xhebeli se kur u shpall ajeti: "E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor) i një të varfëri", çdokush që dëshironte ta prishte agjërimin, e prishte dhe e kompensonte, derisa Zoti e shpalli ajetin: "E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë." Në këtë mënyrë e caktoi Allahu agjërimin e vërtetë dhe ia mundësoi mosagjërimin: të sëmurit, udhëtarit dhe plakut në moshë që s'mund të agjërojë". (Ahmedi).

D. Vlerat etike të agjëruesit

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Agjërimi mbron nga morali i keq sepse ai që agjëron nuk flet gjëra të turpshme dhe nuk bërtet. Nëse (eventualisht) e shanë ndokush ose e sulmon, le të thotë: 'Unë agjëroj, unë agjëroj'." (Buhariu dhe Muslimi)

Transmetim nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Zoti nuk ka nevojë për njeriun që e braktisë ushqimin e pijen e nuk e braktisë fjalën e keqe dhe veprën e ligë." (Buhariu).

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Agjërimi nuk don të thotë të largohesh nga harja e pirja por të largohesh nga fjala e keqe dhe vepra e shëmtuar. Nëse ndokush të provokon apo sillet si i marrë ndaj teje, atëherë thuaj: 'Unë agjëroj, unë agjëroj'." (Ibn Huzejme dhe Ibn Hibbani).

Dh. Prishja me harresë

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kush harron gjatë agjëritimit e pin dhe han, le ta vazhdojë agjërimin sepse Zoti e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë." (Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Maliku).

E. Syfyri (Sahuri)

Transmetohet nga Enes ibn Maliku se Muhammedi a.s. ka thënë: "Hani në syfyr sepse në të ka begati (bereket)." (Ibn Hibbani).

Transmetohet nga Se'id el-Hudrij se Muhammedi a.s. ka thënë: "Bëni syfyr qoftë edhe me një pikë uji". (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu). Ë. Iftari me hurma

Transmetohet nga Selman ibn Amir ed-Dibbij se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kur bën ndokush iftar, le të fillojë me hurmë sepse ajo është begati, e nëse s'gjenë dot, atëherë me ujë, sepse uji është i pastër." (Buhariu, Muslimi dhe të tjerët).

F. Shpejtimi i Iftarit

Transmetohet nga Sehl ibn Sa'di se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Njerëzit do të kenë mirësi gjersa ta shpejtojnë iftarin". (Buhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu). Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Zoti xh.sh. thotë: "Më i dashuri prej robërve të mi është ai që shpejton më tepër iftarin". (Ahmedi dhe Tirmidhiu).

G. Vonimi i Syfyrit

Transmetohet nga Ja'la ibn Murre se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Zoti i do tri gjëra: shpejtimin e iftarit, vonimin e syfyrit dhe lidhjen e duarve njëtrën mbi tjetrën në namaz". (Taberani në Ewsat).

Gj. Të ushqyerit e agjëruesit

Transmetohet nga Zejd ibn Halid El-Xhuheni se Muhammedi a.s. ka thënë: "Kush ushqen një agjërues, fiton shpërblimin sa të tij ashtu që nuk pakësohet as shpërblimi i agjëruesit". (Tirmidhiu dhe Nesa'iu).

H. Namazi i teravive

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi a.s. dëshironte të lutet (falet) në Ramazan pa ndonjë urdhër specifik dhe thoshte:

"Kush lutet (ngrihet e falet) në Ramazan me bindje e kënaqësi, i falen mëkatet e bëra". (Transmetim i të gjithëve).

Transmetohet nga Aisheja r.a. se Muhammedi a.s. është falur në xhami (namazin e teravive) dhe me të janë falur edhe disa njerëz. Kur është falur edhe natën e dytë njerëzit janë shtuar edhe më tepër. Ata janë tubuar edhe natën e tretë e të katërt mirëpo Muhammedi a.s. nuk ka dalur dhe kështu kur ka aguar mëngjesi ai u ka thënë: "Pashë ate që vepruat dhe nuk dola nga frika se mos po ju bëhet obligim, edhe ate në Ramazan" (Buhariu dhe Muslimi).

Transmetohet nga Aisheja r.a. se Muhammedi a.s. nuk shtonte në Ramazan e as jashtë tij më shumë se njëmbëdhjetë reqate. (Buhariu dhe të tjerët).

Transmetohet nga Ibn Abbasi: "I ka falur në Ramazan pa xhemat njëzet reqate dhe namazin e vitrit". (Bejhekiu).

Transmetohet nga Abdurrahman ibn Abdulkarijë: "Shkova me Umer ibn Hattabin në xhami, edhe ate në Ramazan dhe vërejtëm se njerëzit ishin të ndarë e të shpërndarë dhe çdokush falej për vete. Umeri pastaj tha: "Sikur t'i bashkoj ata me një lexues (imam) do të ishte më mirë", dhe i bashkoi nën udhëheqjen e Ubejj ibn Ka'bit. Kur shkuam natën tjetër, i pamë njerëzit se faleshin me një lexues (imam), ndërsa Umeri tha: "Sa risi e bukur është kjo!" (Buhariu dhe Maliku).

Transmetohet nga Jezid ibn Rumani se njerëzit kanë falur në Ramazan gjatë kohës së Umer ibn Hattabit 23 reqate. (Maliku në El-Muvat-ta dhe në të ka shkëputje).

HADITHET E BAJRAMIT

A. Gdhimi i natës së Bajramit

Transmetohet nga Ebu Uname se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Kush lutet (falë namaz) në dy netët e bajrameve me kënaqësi (e sinqeritet), nuk i vdes zemra atë ditë kur do të vdesin zemrat". (Ibn Maxhe, kurse Taberani e transmeton nga Ubade ibn Samiti).

B. Zbukurimi për Bajram

Transmetohet nga Xhabir ibn Abdull-llahu se Muhammedi a.s. e vishte gëzofin (gunën) e kuq të tij në të dy festat e Bajramit dhe në Ditën e xhumasë. (Ibn Huzejme).

C. Ngrënia para namazit

Transmetohet nga Enesi se Muhammedi a.s. nuk dilte ditën e Bajramit të Ramazanit pa ngrënë hurma edhe atë një nga një. (Buhariu dhe Ahmedi).

Ç. Tekbiri në mëngjesin e Bajramit

Transmetohet nga Ibn Umeri se kur (Pejgamberi a.s.) ka dalur në xhami, ka lexuar tekbir me zë të lartë. Sipas një transmetimi tjetër, dilte me agimin e diellit dhe lexonte tekbir derisa të arrinte në xhami. Aty vazhdonte të lexojë tekbir derisa të ulej imami dhe pastaj ndalej. (Shafi'u; Taberani e transmeton nga Ebu Hurejre; Bejhekiu dhe Hakimi nga Ibn Umeri me sened merfu'ë).

D. Namazi i Bajramit

Transmetohet nga Ibn Umeri se Muhammedi a.s., Ebu Bekri dhe Umeri e falnin namazin e Bajramit para hutbes. (Transmetim i të gjithëve përpos Ebu Davudit).

Transmeton Sa'ed ibn Evs el-Ensari nga i ati i tij se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Në ditën e Bajramit, engjëjt ndalen para dyerve dhe thërrasin: "O muslimanë! Shpejtoni te Zoti Fisnik, i cili ju siguron begati dhe ju shpërblen me të mira. Ishit të urdhëruar të faleni (luteni) natën, u falët; ishit të urdhëruar të agjëroni ditën, agjëruat dhe iu nënshtruat Zotit tuaj, pra merrni shpërblimet tuaja!" Gjatë faljes një thirrës thërret: "Zoti i juaj ju fali dhe kthehuni drejtë në vendbanimet tuaja sepse kjo është dita e shpërblimit". (Taberaniu transmeton në veprën e tij El-Kebir transmetimin e Xhabir El-Xhu'fit. Këtë e transmetojnë edhe Bejhekiu me Ibn Hibbanin).

UDHËZIMET E MUHAMMEDIT A.S. RRETH AGJËRIMIT DHE DY BAJRAMEVE

A. Adhurimi dhe bujaria e Muhammedit a.s.

Muhammedi a.s. gjatë Muajit të Ramazanit e shtonte adhurimin. Gjatë këtij muaji Xhebraili ia mësonte Kur'anin. Kur e takonte Xhebrailin ishte edhe më zemërgjerë; ai ishte më zemërgjerë se njerëzit tjerë mirëpo edhe më tepër gjatë Muajit të Ramazanit; gjatë këtij muaji ai shtonte dhënien e lëmoshës, mirësinë, leximin e Kur'anit, namazin, përmendjen e emrit të Allahut (dhikrin) dhe i'tikafin, gjeçjesisht adhurimi dhe bujaria e tij gjatë këtij muaji ndryshonin nga muajt tjerë, ndërsa ndonjëherë agjëronte (edhe natën edhe ditën) me qëllim që sa më shumë kohë të kalojë në adhurim e ibadet, kurse shokëve të vet (as'habëve) nuk ua lejonte agjërimin e vazhdueshëm (natën dhe ditën).

B. Iftari i tij para namazit

Muhammedi a.s. hante iftar para namazit dhe zakonisht fillonte me lëngje, nëse nuk kishte lëngje atëherë me hurma, e nëse nuk kishte edhe hurma, atëherë me ujë.

C. Lutja e tij në Iftar

Transmetohet se Muhammedi a.s. në kohën e iftarit thoshte: "O Zot, për ty agjërova dhe me furnizimin Tënd ha iftar". Gjithashtu transmetohet se ai thoshte: "Përfundoi etshmëria, u ngopën damarët dhe u sigurova shpërblimi, nëse dëshiron Zoti!"

Ç. Mosagjërimi i tij gjatë udhëtimit

Muhammedi a.s. gjatë udhëtimit në Ramazan herë agjëronte e herë jo kurse shokët e tij (as'habët), zgjedhnin njërën prej të dyjave. Muhammedi a.s. i urdhëronte shokët e tij të hanë kur i afroreshin armikut me qëllim që të kenë forcë për ta luftuar.

D. Në dy festat e Bajramit

Muhammedi a.s. falte namazin e të dy Bajrameve në musal-la kurse vetëm njëherë e ka falur në xhaminë e vet edhe ate për shkak të shiut. Falja e tij në musal-la argumentohet me hadithe të transmetuara në Sunenet e Ebu Davudit dhe Ibn Maxhes. Në festat e Bajramit dhe Ditën e xhumasë i vishte rrobat më të bukura. Zakonisht hante hurma para se të dilte në namazin e Bajramit të Madh, kurse në Bajramin e Vogël pas kthimit nga musal-laja dhe hante nga kurbanit.

Sipas haditheve autentike ai në këto dy festa të Bajramit, pastrohej.

Muhammedi a.s. dilte në këmbë, shkonte në musal-la dhe kthehej nga ndonjë rrugë tjetër. Kur arrinte në musal-la, fillonte namazin pa ezan, pa ikamet dhe pa thirrjen: "Namazin në bashkësi!". As ai e as shokët e tij nuk faleshin në musal-la para e as pas namazit (të Bajramit). Ai e fillonte namazin para hutbes, falte dy reqate, përsëriste shtatë herë tekbirin: Zoti është më i madhi (Allahu Ekber) me interval shumë të shkurtë dhe pa cekur diç tjetër. Mirëpo transmetohet nga Ibn Mes'udi, i cili i falënderohet Allahut xh.sh. dhe kërkon mëshirë për Muhammedin a.s. se: "Muhammedi a.s. pas përfundimit të tekbirit lexonte suren el-Fatiha dhe pas saj lexonte suren Kâf: "KÂF - pasha Kur'anin Famëlartë" në një reqat kurse në tjetrin suren El-Kamer: "U afrua koha dhe u nda hëna...".

Ndonjëherë lexonte suren El-A'la: "Madhëroje Zotin tënd më të lartë" apo suren Gashije: "A të erdhi lajmi për belanë që kaplon (kijametin)". Pas përfundimit të leximit merrte tekbir dhe binte në ruku. Kur e përfundonte reqatin e ngrihej nga sexhdja, merrte tekbir pesë herë e pastaj fillonte të lexojë. Në të dy reqatet fillonte me tekbir kurse pas leximit binte në ruku.

Pas përfundimit të namazit, qëndronte para njerëzve të cilët ishin ulur pranë tij, i jepte leje atij që dëshironte të shkojë pa e dëgjuar hutben dhe fillonte hutben, gjegjësisht zhvillonte ligjëratë para tyre e pastaj u ligjëronte grave të cilat edhe jepnin sadaka.

Gjatë hutbes shpesh merrte tekbir.

Këto ishin disa të dhëna rreth asaj se si vepronte Muhammedi a.s. gjatë Muajit të Ramazanit dhe dy Bajrameve.

Zoti i shtoftë ithtarët e tij, na fisnikëroftë me gjurmët e tij dhe na shpërbleftë me të miral!

RREGULLAT E AGJËRIMIT

Obligimi i agjërimit të Ramazanit

Të gjithë muslimanët pajtohen se agjërimi i Ramazanit është obligim (farz), në bazë të ajetit:

"(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramazanit që në të (floi të) shpallet Kur'ani që është udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë..." (El-Bekare:185) Obligim është edhe sipas hadithit të Muhammedit a.s.:

"Islami u ngrit mbi pesë (shtylla): 1. Dëshmisë se s'ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguar i Tij; 2. Faljes së namazit, 3. Dhënies së zekatit; 4. Agjërimit të Ramazanit; 5. Haxhxhit për atë që ka mundësi".

Kushtet e obligimit

Kushtet e obligimit të tij janë:

1. Islami,
2. Mendja e shëndoshë dhe
3. Pjekuria. Agjërimi nuk obligohet për jomuslimanin, as për të çmendurin e as për fëmijën.

Parimet e agjërimit

Parimet e agjërimit janë tre:

1. Hyrja e Muajit të Ramazanit në bazë të pamjes së drejtpërdrejtë të hënës ose në bazë të vendimit të gjykatësit.
2. Largimi nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime prej agimit të mengjesit deri në perëndim të diellit.
3. Vendosja (nijeti)

Koha e vendosjes (nijetit) është para agimit të mëngjesit; duhet të vendoset me bindje të plotë për agjërimin e asaj dite me qëllim që të fitohet shpërblimi i Zotit. Sipas disa shkollave juridike (medhhebeve) mjafton vetëm një vendosje (nijet) gjatë Muajit të Ramazanit pa përsëritje.

Çka e prishë agjërimin

1. Ushqimi i qëllimtë qoftë edhe me pakicë ose me diçka që nuk është ushqyese.
2. Pirja e qëllimtë qoftë edhe një pikë.
3. Barnat ushqyese.
4. Marrëdhëniet intime dhe ejakulimi. Çka urrehet gjatë agjërimit

Urrehet të ndërmerret çdo gjë që e dobëson agjëruesin, si transfuzioni i gjakut apo që mund ta nxitë e ta prishë agjërimin, si puthja e gruas, kontrollimi i ushqimit me gjuhë dhe atë pa nevojë apo hyrja e pluhurit në gojë qëllimisht.

Aspektet pozitive të agjërimit

Agjërimi është adhurim (ibadet) për kontrollimin e epshit, forcimin e trupit, edukimin për bashkëpunim shoqëror si dhe për t'i njohur vuajtjet e të mjerëve e të varfërve...

Kështu, preferohet që gjatë Ramazanit të shtohen: adhurimi, namazi, kërkimi falje (pendimi) dhe leximi i Kur'anit. Gjithashtu është e preferueshme të jepet më shumë sadaka, të ushqyerit e të mjerëve e të varfërve, vizita e fqinjve dhe anëtarëve të familjes, aplikimi i veprave të vlefshme për shoqërinë dhe pakësimi i veprave të padobishme.

Gjatë agjërimit ndalohet çdo gjë që ndalohet edhe jashtë periudhës së agjërimit: gibeti (përgojimi), shpifja, gënjeshtria, armiqësia dhe njollosja e nderit të njerëzve. Pasi që këto vepra ndalohen jashtë periudhës së agjërimit, atëherë si do të trajtohen gjatë Muajit të Ramazanit, i cili është muaj i adhurimit, pastërtisë dhe dëlirësisë!...

Për këta njerëz, Muhammedi a.s. ka thënë se agjërojnë barqet e tyre kurse gjymtyrët bëjnë mëkate: "Shumë agjërues nuk fitojnë gjë, përpos urisë dhe etjes".

Muhammedi a.s. gjithashtu na ndalon dëmtimin e dëmbërësit dhe të sharësit: "Agjërimi mbron nga zjarri e ai që agjëron të mos harrojë një gjë të tillë. Nëse ndokush e nxitë, të mos e shajë e as ta blasfemojë por le të thotë: "Unë agjëroj". (Nesa'iu).

Le ta dijë agjëruesi se nëse dëshiron shpërblim nga Zoti, do ta fitojë; çdo lëvizje që e bën dhe çdo fjalë që e flet konsiderohen adhurim...

Agjëruesi duhet të ketë nijet të pastër, të bëjë më shumë vepra të mira e dhikër dhe të kërkojë falje (istigfar).

SADAKATUL-FITRI - DHËNIA E LËMOSHËS

A. Tekstet argumentuese

Transmetohet nga Ibn Umeri se Muhammedi a.s. e ka obliguar Sadakatul-Fitrin në Muajin e Ramazanit për robin, të lirin, mashkullin, femrën, fëmijën dhe plakun muslimanë, qoftë nga sa'ë hurme ose elbthi. (Buhariu, Muslimi dhe të tjerët).

Transmetohet nga Ibn Umeri se Muhammedi a.s. ka urdhëruar të jepet Sadakatul-Fitri para se të nisen për në namaz. (Transmetimi i të gjithëve përveç Ibn Maxhes).

Transmetohet nga Ibn Abbasi se Muhammedi a.s. e bëri obligim Sadakatul-Fitrin për pastrimin e agjëruesit nga përgojimi dhe fjalët e turpshme; me agjërimin ai (Muhammedi a.s.) e obligon t'i ushqejë të varfërit; ai që e jep Sadakatul-Fitrin para namazit pranohet e kush e jep pas namazit (të Bajramit) është sadaka (lëmoshë) e rëndomtë. (Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Hakimi). B. Rregullat e Sadakatul-Fitrit Vitrat obligohen të jepen para agimit të mëngjesit në ditën e Bajramit të Vitrit (Bajramit të Madh), kurse për atë që vdes në këtë kohë ose lindet pas kësaj kohe, nuk janë obligim. Më mirë është të jepen para namazit të Bajramit si dhe mund të jepen gjatë Muajit të Ramazanit. Nëse vonohen nga namazi i Bajramit, nuk anulohen por patjetër të realizohen. Sadakatul-Fitri i jepet për çdo person një të varfëri, bile nuk lejohet t'u ndahet dy apo tre varfanjakëve, sepse qëllimi i kësaj sadakaje është shpëtimi; ngase Muhammedi a.s. thotë: "Shpëtoni ata nga hallet (barra e rëndë) në këtë ditë". Preferohet Sadakatul-Fitri në të holla, nëse kështu më tepër u konvenon të varfërve.

PJESA E DYTË

1. Ardha e muajit të dashur
2. Ramazani, muaji i të vërtetës
3. Ramazani, muaji i fuqisë
4. Ramazani, muaji i lirisë
5. Filozofia dhe sekretet e agjërit
6. Ramazani, muaji i mirëbërjes
7. Ndikimi i adhurimit (ibadetit) në edukimin e popullit
8. Institucioni i zekatit
9. Ramazani flet
10. Lamtumira e Ramazanit
11. Filozofia e Bajramit

ARDHJA E MUAJIT TË DASHUR

Jemi para një kohe të re të gjithësisë ngase pas disa ditëve do të vjen Ramazani me rregullimin, format dhe atmosferën e vet. Njerëzit ndaj këtij muaji kanë disa qëndrime:

1. Ka njerëz që nuk shohin në të gjë tjetër pos ndalesës së padobishme, traditës së paarsyeshme fetare. Qytetërimi u zhvillua dhe mendimi njerëzor përparoi kështu që, sipas mendimit të tyre, këto pranga të rënda fetare janë të panevojshme. Ky grup tallet me agjëruesit dhe shpotit mendjen dhe qëndrimin e tyre.

2. Ka njerëz që e kuptojnë vetëm si uri të cilës nuk mund t'i përballojë lukthi dhe si etshmëri të cilës nuk mund t'i përballojnë damarët. Ky grup nuk agjëron, paraqitet si agjërues para atij që e njeh kurse si joagjërues para atij që nuk e njeh.

3. Ky grup mendon se Ramazani është kohë e dëfrimit vjetor që përbëhet prej llojeve të ndryshme të ushqimit si dhe si rast i bukur për dëfrim deri në agimin e mëngjesit dhe për gjumë të thellë tërë ditën deri në mbrëmje.

Nëse është punëtor i mërzitët puna, nëse punon me palë sillet keq me to, e nëse është funksionar funksioni i duket shumë i rëndë...

4. Sipas këtij grupi, edhe pse janë pakicë, qëllimi i Ramazanit është diç krejt tjetër sepse ka vlerë të madhe... Ky grup mendon se ky muaj është periudha ushtruese e ripërtëritjes shpirtërore të njerëzve si sjellja fisnike, përshtypja e bukur, durimi i pastër dhe edukata e përsosur hyjnore.

Për ata të cilët mendojnë se agjërimi nuk përkon me zhvillimin e qytetërimit, propozojmë të bisedojnë me mjekët dhe psikologët që t'i shohin zbulimet e reja shkencore që kanë të bëjnë me dobritë e agjërit.

Atyre të cilët dështojnë para urisë, edhe pse e pranojnë obligimin dhe hyjninë e agjërimit, ua rikujtojmë se jetojmë në zemër të luftës definitive në historinë e këtij populli, kurse agjërimi është vetëm durim disaorësh dhe ai që dështon mes agjërimit dhe epshit të vet në durimin që zgjatë gjatë orëve të ditës, atëherë do të dështojë edhe para armiqve të tij në rast të luftës së tmerrshme që zgjatë me ditë, muaj e vite të tëra.

Të dështuarit në një mejdan të vogël nuk janë të aftë të fitojnë për popullin e tyre në ndonjë konflikt më të madh.

Ai që dorëzohet në luftën disaorëshe me epshin e vet, e humbë karakteristikën kryesore të moralit të luftëtarëve, gjegjësisht burrërinë, ndërsa ai që jeton në sferën e burrërisë del ngadhënjimtar ose dëshmor.

Ka një grup që e kuptojnë Ramazanin si uri gjatë ditës dhe kënaqësi materiale gjatë natës... Masës së agjëruësve muslimanë ia kushtojmë këtë ngjarje dhe dëshirojmë që Zoti t'u jep dobi nga agjërimi e t'i shpërblejë me të mira.

Si popujt, ashtu edhe individët, gjatë jetës së tyre të gjatë kanë nevojë për pushim dhe rehati përmirësuese e ripërtëritëse. Koha e pushimit dhe e qetësisimit është pjesë e rasteve definitive në historinë e individëve dhe shoqërive dhe nëse dinë si ta shfrytëzojnë, fitojnë çelësin e të mirave të ardhshme, fitoreve në luftëra dhe përhershëmërinë historike. Shoqëritë dhe individët gjejnë në Ramazan rastin e reformës së historisë së tyre ngase ai prezenton periudhën shpirtërore.

Ramazani është epiqendër për përforcimin e fuqive shpirtërore, psikike e morale në jetën e popullit apo të individit... Ky na rikujton të vërtetën e qiejve dhe të tokës, na armatosë me fuqi ngadhënjyese dhe na nxitë ta duam lirinë, prej së cilës varet nderi i njerëzimit. Pra, Ramazani na dhuron "të vërtetën", "fuqinë" dhe "lirinë" gjatë ditëve të urisë dhe etjes... Çdokush që e kupton

urtësinë dhe filozofinë e agjërimit, lufton për hir të vërtetës me bindje të plotë, ngadhënjën dhe përfiton qëllimin më fisnik të lirisë, gjegjësisht refuzon nënshtrimin dhe robërinë.

Muslimani, i cili agjëron me vullnet të lirë e bindje të plotë për hir të Zotit e afrimit ndaj Tij, vuan nga egoizmi, izolimi dhe indiferenca e shoqërisë dhe kështu orvatet t'i zhdukë e t'i eliminojë; ky musliman agjëruar mendon se epshi, pasioni, dëmi, armiqësia dhe urrejtja janë dobësi që e shkatërrojnë shpirtin e Ummetit dhe për këtë shkak ndien në vete përgjegjësi e obligim për t'u përballuar. Gjatë lutjeve dhe aplikimit të urdhërave të Zotit, ai ndien liri të plotë dhe pavarësi nga çdo gjë tjetër pos Tij, si ushqimi, pirja, kënaqësia, ambicia dhe gënjeshtria. Ai në këtë rast është përgjithmonë i lirë, jo në kuptimin e transferimit prej një vendi në vend tjetër, por në frenimin e epsheve dhe animeve të tij, fundos çka don dhe liron çka don.

Ai kështu qëndron shpirtlirë mes mureve, mendjelirë në vend të shkretë dhe dëshirëlibër në pranga të hekurta...

Pasha jetën time, kjo liri i takon nderit të njeriut, pra si mund të krahasohet me lirinë e trupave! Historia jonë e vjetër dhe ajo bashkëkohore kanë shënuar fitore të mëdha në bazë të këtij koncepti preciz të filozofisë së Ramazanit dhe të modelimit të plotë me edukatën e agjërimit, gjegjësisht në këtë mënyrë i kemi dhuruar botës njerëzore heronj dhe kreshnikë të reformave, çlirimeve, urtësive, shkencës etj...

Shikoni muslimanët, të cilët në betejën e Bedrit që u zhvillua në ditën e shtatëmbëdhjetë të Ramazanit, edhe pse ishin pakicë, korrrën fitore të bindshme, të cilën e amshoi Kur'ani Famëllartë...

A mendoni se do të korrnin sukses sikur të mos i kishte përforcuar agjërimi në shpirtat e tyre fuqinë, të vërtetën dhe lirinë e plotë shpirtërore.

Ata sulmonin me fuqinë e Zotit, qëllonin me fuqinë e Zotit, sulmi i tyre kishte për qëllim të vërtetën.

Pastaj shikoni fitoret tona në betejat e Jermukut, Kadisijes, Xhelules, Hit-tinit etj...! A do të mund të ndodhnin në atë mënyrë mahnitëse, që i habitnin edhe hulumtuesit më të mëdhenj, sikur të mos ishin fituar me karakteristikat e agjëruesve si ndershmëria, krenaria, sakrifikimi, durimi ndaj vështirësive, nënshtrimi para Zotit dhe zhvlerësimi i fuqive destruktive? E gjithë kjo ndodhi me fuqinë e Zotit xh.sh. sepse Ai është ngadhënjyesi më i madh!

T'i shikojmë betejat tona moderne në malet e Oresit, eventualisht trimëritë dhe mrekullitë e Algjerit...! A i shihni ata të cilët luftonin kundër gjysëm milion njerëzve që ishin të armatosur me armë nga Franca, Amerika dhe shtetet e Paktit Atlantik? Jo vetëm atëherë por ende qëndrojnë në revolucionin e tyre edhe pse kaluan 900 ditë Ata e sulmonin armikun e armatosur dhe ushtritë e mëdha me kryelartësi...

A thua vallë do të qëndronin në atë betejë të madhe, qoftë edhe disa ditë sikur të ishin të formuar me shpirtrat e pabesimtarëve që tallen me agjërimin e muslimanëve apo me shpirtrat e të dështuarve që jetojnë nëpër bare e kafene të mbushura me alkool e që s'mund t'i përballojnë urisë dhe etjes disaorëshe?

Jo vëllezër, sepse Islami i ka mësuar me anë të agjërimin në kohën e paqes si të agjërojnë në ditët e luftës... Në luftë nuk e fiton i dobëti të fortin, pakica shumicën, i paarmatosuri të armatosurin përpos nëse është i kalitur me moralin e agjëruesve...

Heronjtë e maleve Ores, Konstantinës dhe Vehranit të Algjerit kanë agjëruar më parë dhe janë përgatitur që me agjërim të luftojnë; agjërojnë (të larguar) nga pushimi dhe nuk dinë se ç'është qetësia e as stabiliteti...; agjërojnë (të larguar) nga kënaqësia dhe nuk dinë kënaqësinë e gruas e as të fëmijës, agjërojnë nga luksi dhe

nuk përjetojnë kënaqësinë e mëndafshit e as të armaçit; agjërojnë nga gjumi dhe nuk dallojnë ditën prej natës; agjërojnë nga dashuria e kësaj bote sepse gjëja më e kënaqshme për ta është shija e vdekjes dhe e flijimit.

Francezët thonë se janë lodhur prej trimërisë së algjerianëve: Kush janë ata, a janë xhinë, djaj apo njerëz të krijuar me zemër të hekurt e nuk e njohin frikën, tmerrin, shkatërrimin dhe zjarrin?

Vaj për kolonialistët që nuk e kuptojnë shkakun e disfatës nga revolucionarët agjërues... Këtu qëndron fshehtësia (e fitores së revolucionarëve), o ju njerëz, sepse francezët, që janë të preokupuar me ushqimin e pëjës, nuk mund të korrin fitore ndaj agjëruesve ngadhënjimtarë e që janë të preokupuar me Zotin e Fuqishëm si dhe të udhëzuar me zemër të pastër ndriçuese.

Pastaj, Ramazani vjen pas disa ditëve... Ata që e trajtojnë si muaj i urisë së ditës, ngopjes së natës dhe leximit formal të Kur'anit dhe fjetjes ditore nëpër xhami, nuk do të kenë kurrfarë dobie prej tij.

Ata që e konsiderojnë si shkollë për përtërirjen e besimit (imanit, bindjes), dhe edukatës, përforcimin e shpirtit dhe vazhdimin e një jete më të mirë e më të përkryer, do të kenë dobi prej tij... Vetëm këta njerëz gjejnë gjatë ditës së tij (Ramazanit) kënaqësinë e trimave të mbuluar me pluhurin e luftërave, kurse gjatë mbrëmjes, natës, syfyrit dhe mëngjesit ndiejnë kënaqësinë e fundit të betejës, shpejtojnë...

Këtyre u hapen dyert e parajsës (xhennetit) në Ramazan, u mbyllen dyert e skëterrës, pranojnë prej engjëjve (meleqeve) në Natën e Kadrit uratë dhe paqe, u falen mëkatet e të këqijat, u mbushen zemrat me dritën e Zotit dhe e përtërijnë famën me fuqinë e besimit (imanit)...

Me ta fitohen luftërat, gëzohen shoqëritë... Nevoja jonë për njerëz të tillë është shumë e madhe sepse sot ballafaqohemi me kolonializëm, gjëra destruktive, korrupsion dhe devijim; të jetojmë ose kryeulur ose kryelartë...

O besimtarë!

O bijtë e këtij Ummeti!

Muhammedi a.s. ligjëroi në ditën e fundit të Muajit Sha'ban (apo si në këto ditë) kështu: "O ju njerëz, është afruar muaji famëlartë dhe i begatshëm, në të cilin është nata që vlerësohet më tepër se një mijë muaj, në të cilin obligohen agjërimi dhe lutja (namazi) vullnetare natën (nafile); kush vepron pak fiton shumë dhe ai që kryen një farz në të sikur ka kryer shtatëdhjetë farze në një kohë tjetër; ky është muaji i durimit kurse durimi shpërblehet me xhennet; ky është muaji i barazisë dhe i shtimit të furnizimit (rizkut) të besimtarit; ai që ushqen ndonjë agjëruar i falen mëkatet, shpëton nga zjarri dhe nuk i pakësohet shpërblimi fare".

Njerëzit i thanë: "O i Dërguar i Zotit, nuk mundet çdokush prej nesh të ushqejë ndonjë agjëruar", kurse ai (a.s.) u përgjigj: "Zoti e shpërblen kështu atë që ushqen ndonjë agjëruar me hurmë, ujë ose qumësht."

Fillimi i këtij muaji është mëshirë, mesi falje (ndjesë) kurse fundi shpëtim nga zjarri. Atë që jep nga pasuria e vet, Zoti e mëshiron dhe e shpëton nga zjarri.

Shtoni (në këtë muaj) katër gjëra: me dy fitoni pëlqimin e Zotit kurse me dy të tjerat jeni të obliguar; dy të parat janë: Deklarimi se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe kërkitimi për faljen (e mëkateve), kurse dy të fundit janë: kërkitimi prej Zotit parajsën (xhennetin) dhe mbështetuni në mbrojtjen e Tij nga zjarri; kush i jep ujë agjëruarit, Zoti i jep atij prej lumit tim dhe nuk ndien etje derisa të hyjë në parajsë (xhennet). (Ibn Huzejme).

Në një hadith tjetër thuhet: "U erdhi Ramazani, muaji i begatisë; me të Zoti ju kaplon, ju zbrit mëshirë, i mbulon gabimet, i përgjigjet lutjes, shikon garat tuaja në te; Tregoni Zotit mirësinë tuaj. I mallkuari privohet nga mëshira e Zotit të Madhëruar." (Taberani).

Këtë e thoshte i Dërguari i Zotit para Ramazanit, i nxiste besimtarët në lutje e adhurim, i mbushte zemrat e tyre me begatitë dhe mëshirat që dërgoheshin ato ditë dhe i frymëzonte shpirtrat me të mirat e agjërimit si fuqia, ndriçimi, hyjnim i etj.

Përgatituni për Muajin e Ramazanit, edukohuni me edukatën e tij dhe fitoni dobi prej urtësisë dhe fshehtësive të tij.

Eni o besimtarë, sepse janë hapur dyert e parajsës! O ju që keni bërë lëshime, ejani, sepse Zoti ua ka ofruar mëshirën e Vet!

RAMAZANI, MUAJI I TË VËRTETËS

"E populli yt e konsideroi atë (Kur'anin) të rremë, porse ai (Kur'ani) është i vërtetë. Thuaj: 'Unë nuk jam roje e juaj.'" (El-En'amë: 66)

Mjafton t'i themi muslimanit: "Zoti urdhëron të agjërosh" e ai të agjërojë pa i numëruar dobitë dhe sekretet e agjërimit, mirëpo jemi të detyruar të ndërmarrim një hap të tillë për dy shkaqe:

1. Zoti i Madhëruar na informon në shumë ajete të Kur'anit Famëllartë për dobitë dhe sekretet e sheriatit që të mendojmë e punojmë dhe të bindemi se sheriat i hyjnor i përhershëm është shpallur vetëm për të realizuar interesin e njerëzve dhe për t'i mënjanuar dëmet prej tyre. Shiko fjalën e Tij (xh.sh.) mbi etikën e kërkimit leje për hyrjen në shtëpi të huaj kur thotë se një gjest i tillë është më i mirë për ta: "O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaj

pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim". (En-Nur:27).

Gjithashtu edhe kur na urdhëron të agjërojmë i cekë dobite dhe urtësinë e Tij me një fjalë: "O ju besimtarë, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." (Bekare:183).

Urtësia e obligimit të agjërit, ashtu siç e potencon Zoti, xh.sh. fshehet në devotshmërinë që nënkupton çdo gjë të mirë që e don Zoti e që falënderohet njeriu për të në këtë botë, kurse mbrojtja nënkupton largimin prej çdo veprë të urryer e të dëmshme për shoqërinë dhe individin. Shih hadithin e Muhammedit a.s. rreth dobive të agjërit:

"Agjërimi është mbrojtje ngase agjëruesi s'përgojon e as që bën mëkate".

Dobitë nga agjërimi numërohen me qëllim që të ndikojnë më tepër në shpirt e të kenë ndikim më të thellë, kurse muslimani të jetë më tepër i bindur në adhurim e në Sheriat.

Një gjë e tillë është cekur edhe më parë kur Ibrahim i a.s. kërkoi prej Zotit t'i tregojë se si i ringjallë të vdekurit..! Kur e pyeti Zoti se "a nuk beson?", ai u përgjigj: "Po, por të qetësohet zemra ime".

Analizimi i rregullave dhe shpalimi i sekreteve të tyre nuk kundërshtojnë imanin e as që prezantojnë dobësinë e bindjes ngase vetë Muhammedi a.s. i analizonte dhe i arsyetonte.

2. Disa njerëz mendojnë se kanë qëndrim të lirë ndaj të kuptuarit të feve dhe besimeve dhe duke u mbështetur në këtë parim, dyshojnë në to dhe i kritikojnë sepse e pranojnë vetëm atë që e pranojnë intelektet e tyre dhe logjika. Pasi që Islami nuk e mohon rolin e intelektit, u flet njerëzve për atë që përputhet me mendjen e shëndoshë dhe logjikën e arsyeshme dhe obligon atë që është në favor (të njeriut) nëse urdhërohet ose ndalohe. Atëherë

nuk na pengon gjë që të mbështetemi edhe në analizat racionale të fshehtësive dhe dobive të sheriatit. Të gjithë njerëzit, në çdo kohë, i kanë përjetuar dobitë e sheriatit që përputhen me mendjen, logjikën dhe interesin e tyre, pra ky është argument se pas këtij sheriatit qëndron fuqia dhe caktimi i Zotit Mëshirues, të Urtë e të Gjithëdijshtëm. "(Kjo është) mjeshtri e Allahut që përsosi çdo send". (En-Neml:88)

Me këto analiza u orvatëm t'i qetësojmë zemrat e muslimanëve për obligimin e agjërimit dhe t'ua vërtetojmë refuzuesve dhe mohuesve urtësinë dhe filozofinë e tij. Këtë vlerë të Islamit s'mund ta mohojë askush!

Të shohim tani se çfarë urtësie ka agjërimi dhe cilat janë dobitë e tij?!

Ne këtu nuk do të flasim për dobitë shëndetësore sepse shpjegimi i tillë është përgjegjësi e mjekut ngaqë Zoti urdhëron që t'i pyesim dijetarët përkatës, pra, t'ua lëmë aspektin shëndetësor të agjërimit mjekëve që mund të na njoftojnë më tepër rreth zbulimeve të mjekësisë moderne. Këtu do të përqëndrohemi në dobitë psikike, shpirtërore e morale të agjërimit. Kjo temë është shumë e gjerë dhe s'kemi mundësi të hyjmë në detaje të hollësishme që distribuohen nëpër mediumet informative, por do t'i cekim vetëm dobitë që kanë të bëjnë me shoqërinë, individët dhe gjendjen momentale të shoqërisë sonë.

Një ndër aspektet më të rëndësishme të edukatës shoqërore që ka të bëjë me ndikimin e agjërimit në shpirtrat e agjëruesve, është përforcimi i bindjes në të vërtetën, konfirmimin, thirrjen në të (të vërtetën) dhe në formësimin me të.

E vërteta në Islam ka vlerë të madhe, bile është edhe një prej emrave të Zotit (El-Hakk): "Këtë (e themi për ta ditur) se Allahu është Ai i Vërteti", (El-Haxhxh:6); e vërtetë është ajo që e thotë Zoti i Madhëruar: "Fjala e Tij është e njëmendtë dhe Atij i takon

sundimi". (El-En'am:73), apo: "E vërteta është nga Zoti yt", (Bekare:147).

Për këtë, mesazhet e pejgamberëve përmbanin thirrjen në të vërtetën dhe përhapjen e saj midis njerëzve: "Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame) e (kur u përçanë) Allahu dërgoi pejgamberët përgëzues dhe qortues, dhe atyre Ai ua zbriti edhe Librin me fakte të sakta për të gjykuar në atë që u kundërshtuan ndërmjet veti". (El-Bekare:213).

Mesazhi i Islamit është periudha e fundit e shariateve, thirrje në të vërtetën dhe konfirmues i synimeve të të vërtetës: "O ju njerëz, juve u erdhi i Dërguari me të vërtetën (fenë e drejtë) nga Zoti juaj". (En-Nisaë:170).

Pasi që qëllim i Islamit është "e vërteta", atëherë në fillim duhet të ceket adhurimi i Zotit, Krijuesit, Formuesit dhe Furnizuesit tënd me begatitë e shumta. Është kob i madh e i papërshtatshëm për njeriun nëse e harron adhurimin e Tij dhe fuqinë e Tij mbi të.

Njerëzit hyjnizohen, dëmbërësit dëmtojnë dhe tiranët keqtrajtojnë atëherë kur e harrojnë adhurimin dhe kur ia mvëshin vetes atributet e Zotit, ashtu që lejojnë derdhjen e gjakut, marrjen e shpirtrave, mendjemadhësinë në tokë, dëmtimin, robërimin e popujve dhe shkeljen e nderit të tyre...

Faraoni ndjehej i madh në tokë dhe i fuqishëm: "O ju pari, unë nuk njoh ndonjë zot tjetër për ju pos meje". (El-Kasas:38). Kështu, i vriste njerëzit, i dhunonte gratë dhe i internonte udhëzuesit dhe prijësit më fisnikë të popullit. Tiranë e tij vazhdoi derisa i erdhi vdekja përkujtuese: "Derisa e përfshiu atë përmbysja, e ai tha: 'Besova se nuk ka zot tjetër pos Atij që i besuan beni israilët, edhe unë jam nga muslimanët!'..." (Junus:90).

Gjatë agjërimit njeriu e ndien veten njeri, apo ndien se është rob që ka nevojë për ushqim e pije, i shmangur nga çdo fuqi dhe barabarësohet me jetën e njerëzve të tjerë, si në ushqim, vendbanim ashtu edhe në veshmbathje...

Gjatë agjërimit mbretërit, udhëheqësit, prijësit, komandantët, të fuqishmit, të pasurit dhe të autorizuarit me privilegje ndjejnë në vete se i ngjajnë popullit për shkak se kanë nevojë për furnizimin, ushqimin dhe pijen e Zotit; ndjejnë se u ngjajnë të varfërve dhe njerëzve të dobët për shkak të urisë, ushqimit, ujit... gje gjësisht pse e privojnë popullin nga ushqimi dhe pirja? Pse e pengojnë të drejtën e tij, sepse sikur t'i dobësonte Zoti xh.sh. faktorët e fuqisë së tyre, do të ishin të dobët në tokë, të poshtëruar e të degraduar?

Këtë e rikujton për herë të parë agjëruesi (qoftë mbret apo tiran), sepse një gjë të tillë mund ta harrojë jashtë Ramazanit... Sa e bukur është lutja e besimtarit kur bën iftar e thotë: "O Zot, për ty agjëroj dhe nga furnizimi Yt filloj iftarin". Ai këtu pranon se furnizimi, pasuria dhe dhurimi janë të Tij dhe se e posedon vetëm atë që ia jep Zoti. Kjo është një ndër karakteristikat më të çmueshme të adhurimit dhe të attributeve të Tij.

Është e vërtetë se njeriu duhet përherë ta rikujtojë lidhjen e vet me Ummetin dhe të jetojë përherë në zemrën, shpirtin dhe jetën e tij; aty të dëfrehet e të pikëllohet; tirani e sundon shoqërinë e tij vetëm kur harrohet kjo e vërtetë ngase paramendon se është gjeni, ka fuqi dhe personalitet; Kështu njerëzit i përkulen, pranojnë paaftësinë e tyre para tij dhe e përcjellin mendimin e tij... Nëse ndonjëri prej tyre thotë, "Jo", tirani përgjigjet me mendjemadhësi: "Vrit, burgos dhe interno!"

Të pasurit sillen brutalisht ndaj të varfërve, të afërmit i këpusin marrëdhëniet familjare dhe fqiu refuzon të drejtën e fqit vetëm atëherë kur e harrojnë lidhjen shoqërore dhe kur çdokush jeton për vete e jo për njerëz, jeton me barkun dhe epushin e tij gjinor e jo me

nevojat dhe kërkesat e popullit... Gjatë agjërimit njeriu rikujton se i përket shoqërisë, është prej saj, me të, për të dhe në afërsi të saj... Ai jeton në uri me shoqërinë, ushqehet së bashku me të dhe feston me të...

Vetëm atëherë i rikujton ato, nevojat e tyre, urinë e të varfërve, ndien mjerimin dhe nevojën e tyre; pra, sikur të mos ishte agjërimi, nuk do t'i rikujtonte... Kështu, shpirti i agjëruesit bëhet më i lartë, më njerëzor dhe më afër zemrave të njerëzve...

Muslimani i parë, Muhammedi a.s. ishte njeri shumë bujar, mirëpo gjatë Ramazanit i ngjante puhisë që sjell dobi, jetë dhe ringjallje...

Aisheja r.a., gjatë Ramazanit i ka dhuruar popullit të vet njëqind mijë dirhemë ndërsa për vete i ka ruajtur teshat e rëndomta... Guvernatori për këtë e ka pyetur: "Sikur të bësh diçka për iftarin tonë të sodit!", kurse ajo është përgjigjur: "Pasi që ma rikujtove, do të lëmë", pastaj ka vazhduar: "A shihni o ju njerëz, se si lartësohet shpirti i agjëruesit aq sa i harron nevojat dhe kërkesat e vetvetes dhe i rikujton vetëm nevojat e popullit të vet! Këtë e kërkon Zoti prej agjëruesve".

Është e vërtetë se kryetarët, udhëheqësit, funksionarët dhe politikanët nuk duhet të punojnë për hir të autoritetit ose pozitës së tyre por për hir të Zotit xh.sh., nëse populli refuzon vlerën e tyre atëherë nuk do t'i përkasin refuzimit, nëse e pranojnë vlerën e tyre nuk do mashtrohen me verbimin nga pasioni, nëse kanë nevojë për të (popullin), nuk do të hasin në mashtues e lajkatarë; kështu populli fiton lumturinë së bashku me udhëheqësit dhe prijësit e vet kurse Zoti i bekon ata udhëheqës e prijës për veprat dhe përpjekjet e tyre..., e në të kundërtën, vjen mjerimi dhe vuajtja.

Me agjërime mëvetësohet edukata e përsosur... Agjërime është adhurim i fshehtë mes njeriut dhe Zotit të tij pa kurrfarë hipokrizie e tradhtimi, nuk kërkon lavdërim e as mirënjohje... Muslimanit

agjërues i mjafton dituria e Zotit për urtinë, përlulen dhe vendimin e sigurtë; nga shpërblimi i Zotit xh.sh. i mjaftojnë pastërtia nga hipokrizia e tradhtimi dhe shqeriteti e besa e gjuhës së tij...

Turpërohet prej gënjeshtërs, vjedhjes, gjetit (përgojimit), dëmtimit dhe armiqësisë ndaj njerëzve sepse Muhammedi a.s. thotë:

"Zoti s'ka nevojë për largimin e ndonjërit nga ushqimi dhe pirja nëse ai nuk e braktisë gënjeshtren."

Muhammedi a.s. gjithashtu e ka ndaluar agjëruesin t'i kundërvihet të keqes me të keqe, paturpshmërisë me paturpshme;

"Nëse ndokush e shanë ose sulmon, le të thotë: 'Unë agjëroj', apo unë jam engjëll i tokës sime! Nuk gënjej, as nuk sulmoj e as s'dëmtoj..." Sa me vlerë është morali i tillë, për të cilin kanë nevojë para së gjithash udhëheqësit e politikanët, posaçërisht në Ramazan e në këtë kohë aktuale!

Është e vërtetë se njeriu nuk ka vetëm natyrë trupore materiale dhe se nuk mund të arsyetojë se qëllimi i tij në jetë është vetëm ushqimi trupor, por në vete ka edhe natyrë të engjëjve, shpirtit dhe zemrës.

Kur e harron njeriu këtë të vërtetë, bie në një nivel më të ulët se të kafshës. A nuk i sheh njerëzit e Perëndimit, të cilët janë shndërruar në rrezik për njerëzinë në atë çast kur e humbën engjëlloren dhe përkrahën shtazoren?!

Gjatë agjërimit barku ndjen uri kurse shpirti ushqehet, pastrohet trupi e zemra forcohet, dobësohet epshi e lartësohet shpirti... Në këtë muaj të bekuar besimtari gjen kohë për t'iu lutur Zotit, për leximin e Kur'anit Famëlartë që është libër i përhershëm, edukativ, reformist dhe pastrues i shpirtit.

Në Ramazan muslimani dëgjon fjalët e Kur'anit të cilat e ftojnë në mirëbërje, adhurim dhe e largojnë nga e keqja dhe mëkati. Në këtë muaj muslimani i dëgjon fjalët e Zotit: "Afrohu o robi Im! Pasi që kjo botë të largoi prej Meje edhe pse jam më i afërt se damari i qafës, pasi që të demoralizoi djalli nga mëshira Ime edhe pse ajo kaplon çdo gjë, pasi që u mashtrove me autoritetin që ta dhurova dhe mendove se s'ke nevojë për Mua, edhe pse nuk mund ta shpëtosh gjënë që ta rrëmben miza dhe pasi që ke ra në një shkallë më të ulët se kafshët, edhe pse të krijova si mëkëmbës Timin në tokë... Eja te Unë, o robi Im, që të të lartësoj në shkallën e engjëjve të Mi e të jetosh me shpirt të lartë, ndriçim shpirtëror dhe dritë të zemrës. Në këtë mënyrë do të jetosh në parajsë para se të hysh në te."

O vëlla besimtar!

Këtë të vërtetë që e vërteton agjërimi në unin tënd, e ka vërtetuar edhe në paraardhësit tanë dhe për këtë shkak kanë qenë mrekulli e Islamit. Njerëzimi nuk njeh diçka që mund të krahasohet me shpirtin e tyre të lartë, qëllimin e ndershëm, synimin fisnik, ndriçimin e shpirtit dhe udhëzimin e zemrës.

A s'ka njerëzimi sot nevojë për një gjeneratë të tillë, a s'ka nevojë shoqëria jonë për njerëz të tillë?

A nuk sheh dëmin, humbjen, korrupsionin dhe amoralitetin që e kanë kapluar shoqërinë tënde? Ku është jehona e së vërtetës në shoqërinë tënde?

A pranohet që popujt tanë të jetojnë nën presionin e hekurit dhe zjarrit e në shpinat e tyre të fëshkëllojnë kërbacët e xhelatëve?

A pranohet që popujt tanë të jetojnë në mjerim e vuajtje ndërsa pasurinë ta shrytëzojë një pakicë e pasur dhe cinike?

A pranohet që këto parti t'i gënjejnë popujt tanë me fjalë të ëmbla për të arritur pozitë, fitim e autoritet?

A pranohet që politika të jetë mashtrim, gënjim dhe humbje apo nxitëse e instinkteve dhe devijimit të popullit?

A pranohet që feja të jetë tregti për disa juristë apo shkenca të jetë idhujtari për disa dijetarë? A pranohet që autoriteti i disa injorantëve të poshtër të jetë mjet nënshtrimi dhe shfrytëzimi?

O vëlla besimtar!

Pasi që Islami kërkon prej nesh që të jemi në çdo kohë mbrojtës të së vërtetës dhe më të sigurtë ndaj saj, atëherë a hasë në Ramazan diçka që ta mundëson predikimin e këtij mesazhi në popujt e botës?

A gjete në Ramazan atë që të lartëson aq shumë saqë të shndërron në udhëheqës nga e mira dhe paqja?

A nuk të afron Ramazani me Zotin tënd të Vërtetë edhe atë nëpërmjet të Dërguarit të Tij, Librit të vërtetë dhe udhëzimit të sheriatit të drejtë?...

Dëgjo atë çka të thotë Zoti xh. sh. me anë të ajeteve të agjërimit:

"E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen Mua dhe le të më besojnë Mua." (Bekare, 186)

RAMAZANI, MUAJI I FUQISË

"Nuk është i fuqishëm ai që tërbohet por ai që kontrollon veten në çastin e shqetësimeve të mëdha." Hadith

Kjo jetë prezenton konfliktin në të cilin fitojnë të fuqishmit. Fuqia është dylojesh: fuqia materiale dhe fuqia shpirtërore (ideologjike). Sipas parimeve islame, fuqia materiale ndonjëherë mund të korrrë fitore të përkohshme dhe nuk do të jetë dobiprurëse. Kur'ani na rrëfen për popujt e hershëm për të cilët thuhet se kanë qenë të fuqishëm në aspektin e jetës materiale. Për këtë shkak është përhapur në tokë korrupsioni e devijimi, janë luftuar të dërguarit e Zotit e përgënjeshtuar thirrjet reformiste dhe kanë mbizotëruar dekadencia e shkatërrimi.

Dëgjo ç'thotë Kur'ani Famëllartë rreth tyre:

"A nuk e di ti se ç'bëri Zoti yt me Adin? Me banorët e Iremi me ndërtesa të larta? Që si ata (populli Ad) nuk është krijuar askush në tokë! Dhe me Themudin, të cilët shpuan shkëmbinj në luginën (Kura). Dhe me faraonin e fortifikuar me tenda (ushtarake)! Të cilët e tepruan me krime në tokë. Dhe në të shtuan shkatërrimin. E Allahu kundër tyre lëshoi lloj-lloj dënimesh. Pse Zoti yt është që përcjell (u rri në pritë)." (Fexhër:6-14)

Në një ajet tjetër thuhet:

"A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shikojnë se si përfunduan ata që ishin më parë, të cilët ishin edhe më të shumtë prej tyre dhe më të fortë për nga forca e ndikimit në tokë, por ajo që fituan, nuk u ndihmoi asgjë. Kur u erdhën atyre të dërguarit me argumente të qarta, ata iu gëzuan dijenisë së vet dhe atëherë i përfshiu ajo që e tallnin." (Gafir:82-83)

Ky është fundi i popujve të cilët u mbështetën në fuqinë materiale pa atë shpirtërore ideologjike, gjë që rezultoi me mosrespektimin e besimit, moralit dhe jetës shpirtërore.

Fuqia shpirtërore pa atë materiale, sipas Islamit, nuk do të korrë sukses dhe s'mund ta udhëheqë jetën. Gjatë historisë kemi parë popuj që jetuan të shkelur, të nënshtruar e të keqtrajtuar, sepse nuk luftonin e as që i përballonin ndokujt në jetë dhe kështu pësuan disfatë nga të fuqishmit.

Rruga e vërtetë e jetës së lumtur e fisnike është të harmonizohet materia me shpirtin për ta përforcuar njeriun dhe jetën e tij si dhe të mbështetet populli në të dy fuqitë: fuqinë e materies dhe atë të shpirtit; nuk sundon njëra mbi tjetrën. Kështu ngjitet në qiejt e lartë duke mos u frikuar nga tatëpjeta. Kur'ani na mëson ta lusim Zotin kështu:

"O Zot, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër."

Kur'ani na obligon ta përforcojmë besimin, kontrollojmë epshin dhe lartësojmë shpirtin; ai na urdhëron të përgatitim fuqi maksimale: "E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhetojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët". (El-Enfalë: 60)

Ai gjithashtu na urdhëron të falim namazin e të japim zekatin sepse këto dy aspekte paraqesin faktorët kryesorë të fuqisë shpirtërore ideologjike si dhe urdhëron të punojmë: "Dhe me atë që ta ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë." (El- Kasas: 77)

Gjithashtu na urdhëron t'i zbulojmë pasuritë e tokës dhe fshehtësitë e gjithësisë (qiellit) "Thuaj: 'Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në tokë.'" (Junus: 101)

Kur'ani na urdhëron të luftojmë në rrugë të Zotit xh. sh. dhe ta sakrifikojmë jetën për hir të së vërtetës sepse xhihadi është një ndër fenomenet më të mëdha të fuqisë, lëvizjes dhe punës, gjegjësisht në këtë frymë filloi thirrja islame në kohën e

Muhammedit a.s. dhe u zhvilluan luftërat, kurse Muhammedi a.s. nuk ishte i fortifikuar por luftoi së bashku me ta (muslimanët), e udhëhoqi ushtrinë, sulmoi, fitoi, u plagos... Fitorja ishte në anën e thirrjes që i bashkoi të dy fuqitë kundër idhujtarisë që kishte dobësuar mendjen, moralin dhe fuqinë luftarake të arabëve.

Islami konfirmon se fuqia shpirtërore me pak fuqi materiale ka sukses kundër fuqisë materiale nëse humbet faktori psikik ideologjik: Për këtë, në Kur'an thuhet:

"Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha! Allahu është me durimtarët." (Bekare: 249)

Shembull më i qëlluar për këtë është beteja e Bedrit, ku muslimanët, numri i të cilëve ishte treqind, fituan në Bedër edhe pse ishin arabë si kurejshitët që ishin afër një mijë. Ata ishin të afërmit e tyre, prej një vendi, një popull dhe me karakteristika identike; kurse armët e njëmijëshit ishin më të shumta se ato të treqindëshit... Por, muslimanët kishin fuqinë e besimit, moralit e shpirtit, gjë që nuk e kishte opozita pabesimtare dhe për këtë dështuan ashtu që disfata e tyre u shënua në Kur'an në një formë ideale që tregon se ç'mund të bëjë fuqia shpirtërore ndaj asaj materiale nëse vlerësohet minimalisht fuqia e armës.

Në Kur'an ceket shembulli i individit që i bashkon të dy fuqitë dhe fiton e korrë sukses, gjegjësisht Musa a.s. i cili u mbushi ujë dy vajzave dhe eci me to deri te babai i tyre pa i shikuar fare për shkak të turpit, moralit dhe fisnikërisë. Njëra prej tyre i tha babait të saj:

"O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, sepse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besnikul!" (Kasas: 26)

Po ashtu në Kur'an ceket edhe shembulli i popullit që bashkon të dy fuqitë dhe që ngadhënjën: "Muhammedi është i dërguar i

Allahut, e ata që janë me të (as'habët), janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh ata kah përulen (në ruku) duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), dhe kërkojnë nga Allahu që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre". (El-Fet'h:29)

Ky është fryti i bashkimit të të dy fuqive dhe elementi kryesor i lumturisë së popullit të sinqertë. Agjërimi, të cilin e obligoi Allahu xh. sh. për muslimanët, përmban në vete bashkimin harmonik të dy fuqive, që jep fryt ideal, sepse në aspektin shëndetësor prezenton fuqinë e trupit kundër shumë sëmundjeve, kurse në aspektin ideologjik muslimanit i dhuron tri fuqi ideologjike që ndikojnë më së shumti në lumturinë e individëve dhe të shoqërive.

Durimi

Muslimani gjatë Ramazanit duron në uri e etje, braktis gjërat që zakonisht i praktikon gjatë ditës, si kënaqësitë dhe lëngjet freskuese, pra me vetdëshirë abstenon e duron e jo nga frika e burgut, kërcënimi i trupit dhe i pasurisë.

Durimi vullnetar në kënaqësitë e epsheve ka më tepër dobi për shpirtin dhe popullin se ai i obliguar nga mospasja, dënimi apo maltretimi.

Ushtari i cili nuk ka mësuar të agjërojë vullnetarisht në kohën e paqes nuk do të jetë më i durueshëm në betejë gjatë rrethimit eventual nga armiku dhe ndërprerjes së lidhjeve mes tij e eprorësisë.

Ushtari musliman duron urinë njëmujore në çdo vit dhe atë disaorëshe në ditë derisa shmangia nga gjërat e shndërruara në vese të ditës, si duhani, çaji dhe kafja, të bëhet për të e rëndomtë. Vetë e kam përjetuar gjatë burgosjes sime në Luftën e Dytë Botërore se si të burgosurit e humbnin vetëdijen për shkak të urisë disaditëshe. Vetëdijen e humbnin ata që nuk ishin mësuar të agjërojnë kurse ata

që zakonisht kishin agjëruar më parë, urinë e pranuan si të rëndomtë në jetën e tyre, gjë që shkaktoi habi të madhe.

Durimi në rastet e vështira paraqet armën më të fuqishme për popujt sepse një durim i tillë në mesin e betejës është faktor kryesor për ta mundur armikun.

Ne e dimë, se një ndër problemet më të mëdha të eprorësisë luftarake bashkëkohore është furnizimi i ushtarëve me ushqim dhe disponimi i tyre nëse gjenden larg vendit dhe familjeve të tyre...

Shpeshherë shohim se ushtria perëndimore merr me vete një grup lavresh për t'i disponuar ushtarët. Krahaso këtë me ushtrinë islame që zhvillonte luftëra dhjetëvjeçare në Gadishullin e Arabisë pa patur probleme me ushqimin dhe disponimin e ushtarëve. Problemi i ushqimit zgjidhej për shkak se ushtria islame përbëhej prej ushtarëve që nuk i jepnin rëndësi kënaqësisë ushqimore por sakrificimit për të hyrë në parajsën (xhennetin) e gjerë aq sa qiejt e toka... Ushqimi për ta ishte vetëm materie për lukthin dhe përforcimin e trupit, nëse gjenin mish e qumësht, nuk ngopeshin, e nëse gjenin hurma e ujë ngopeshin dhe nëse nuk ushqeheshin me ditë e netë të tëra veten e konsideronin si agjëruar të Ramazanit..!

Sa i përket disponimit të tyre, ata e gjenin atë në adhurim sepse kishin fuqi shpirtërore, pastërti të besimit dhe moral të lartë. Po, pasha Zotin, disponimin e pashës e largonin kurse në anën tjetër e forconin veten për luftë kundër armiqve të tyre, edhe ata me anë të adhurimit gjatë natës deri para agimit të mëngjesit sepse lexonin Kur'an, lutnin (Allahun) dhe mësonin orë të tëra para se ta kryenin namazin e mëngjesit. Ata vetëm ashtu e gjenin fuqinë në shpirtat e tyre dhe qetësinë e zemrave të tyre. Kështu vepronin çdo ditë pas përfundimit të betejës e ju mund t'i paramendonit mundimet e atëhershme të luftëtarëve... Arma e bardhë, shigjetat e përpikta dhe kuajt e shaluar ishin armët e tyre, me të cilat luftonin ballë për ballë armikun, çdo ditë prej mëngjesit deri në mbrëmje, gjegjësisht deri

në kryerjen e namazit të jacisë, pastaj pushonin disa orë në tendat e tyre. Pas pushimit çoheshin, i drejtoheshin Allahut xh. sh. dhe i luteshin me zemra të pastra sepse vetëm lutjet dhe leximi i Kur'anit i dispononin shpirtat e tyre.

Ata vepronin kështu... A s'keni dëgjuar si erdhi deri në tubimin e Kur'anit gjatë kohës së Uthmanit r.a.? Hudhejfe ibn El-Jeman, komandant i ushtrisë islame, i cili luftonte në Azerbajxhan, dëgjonte lexime të ndryshme të muxhahidinëve gjatë kontrollimit të tij natën nëpër tendat e tyre para namazit të mëngjesit.

Ata lexonin aq shumë saqë zëri i tyre i ngjante gumëzhimit të bletëve!!

Kjo është fshehtësia e fitores se tyre mahnitëse e të mrekulluar, të cilën na e rrëfen historia si të pakrahasueshme. Kjo është fshehtësia e disfatës së ushtrive persiane e romake që kishin moral të shkatërruar, shpirt të pandritshëm, johuman e joideologjik, ashtu siç është rasti me ushtritë e Perëndimit, të cilat vazhdojnë luftën në qoftë se kanë pranë vetes pije alkoolike dhe lavire. Hyrja e tyre në beteje realizohet vetëm pas sigurimit të ushqimit dhe furnizimit disamujor!

Respektimi

Muslimani i cili agjëron në Ramazan, largohet nga ushqimi, pija dhe tradita e përditshme për shkak të respektimit të urdhërit të Zotit xh. sh. dhe nderimit të Muhammedit a.s., dhe për këtë, ai nuk mendon se a do të jetojë në qetësi apo në vështirësi sepse për të mjafton besimi në një Zot dhe pranimi i Muhammedit a.s. si i dërguar e udhëheqës; ai është betuar në Islamin e tij qoftë në rrethana të volitshme apo të pavolitshme, të mira apo të këqija.

Kështu, ushtari musliman ishte shembull ideal i respektimit që realizohej me vullnet dhe bindje të thellë shpirtërore.

A do të përfitonte Halidi virtytin më të lartë, i cili u revokua nga posti si komandant i ushtrisë dhe u shndërrua në ushtarë të thjeshtë që luftonte me të njëjtën energji, duke thënë: "Unë luftoj për hir të Zotit të Umerit e jo për Umerin", sikur të mos e kishte thelluar Islami në shpirtin e tij atë moral të lartë që përbëhej prej agjërimit, namazit dhe parimeve tjera islame?

A do të realizoheshin shembujt e mrekullueshëm në historinë e Ebu Bekrit, Umerit, Halidit, Sa'dit dhe kolosëve tjerë muslimanë sikur të mos ishte ngulitur agjërimi në karakterin e devotshmërisë së tyre të vetëdijshme gjersa e respektonin njëri-tjetrin dhe vepronin bashkërisht?

Çka vëreni në ushtrinë e Usames, të cilën e përgatiti Muhammedi a.s. pak para vdekjes ashtu që pleqësia e muhaxhirëve dhe ensarëve, si Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Halidi të jenë nën komandën e të riut Usame ibn Zejd, i cili ende nuk kishte mbushur njëzet vjet?

Si i shpjegoni fjalët e Ebu Bekrit drejtuar Umerit pas vdekjes së Muhamedit a.s., kur Umeri kërkoi që të caktohet komandant ndonjë që është në moshë dhe më me përvojë: "I Dërguari i Zotit ta caktojë e unë ta largoj?!"

Si e kuptoni respektimin e çuditshëm të porosive të Muhamedit a.s. para dhe pas vdekjes së tij? A nuk është ky respekt fryt i ndikimit të agjërimit në edukatën e muslimanëve për respektimin e komandantit të dashur?! Po, këtë e dëshmon edhe vetë historia!

Disiplina dhe organizimi

Muslimani gjatë Ramazanit ushqehet, fle e zgjohet në mënyrë të disiplinuar e të organizuar. Organizimi i shoqërisë islame gjatë Muajit të Ramazanit realizohet në formë të përkryer sepse uria ditore është e përbashkët, bashkërisht në një kohë hanë iftarin,

bashkërisht falin namazin e jacisë, teravisë, mëngjesit... Ky lloj organizimi s'krahahet me asnjë shoqëri tjetër sepse në të barazohet plaku me të riun, dijetari me të paditurin, sunduesi me të sunduarin, i pasuri me të varfërin; nuk dallohen klasat njerëzore e as individët njëri prej tjetrit.

Sa i mrekullueshëm është agjërimi në sytë e hulumtuesve, si vegël për edukimin, respektimin dhe organizimin e popujve?!

Ky është morali kryesor që thellohet në shpirtin e muslimanit nën ndikimin e agjërimit: durimi, respektimi, organizimi, disiplina...

A mendoni se një popull që i posedon këto fuqi shpirtërore do të shkatërrohet?

A mendoni se ushtria e kalitur me këto elemente të fuqishme të moralit do të pësojë disfatë? A mendoni se në shoqërinë ku mbizotëron morali i tillë i fuqishëm do të përhapet amoraliteti?

Pasha Dërguesin e Muhammedit a.s. si peygamber, sikur ta posedonim sot këtë moral në konfliktin tonë me Izraelin, do të ndikonim shumë edhe sikur ta posedonim gjysmën e armëve dhe pajisjeve të tyre!

Sikur t'i posedonim armët ideologjike e shpirtërore, do ta shndërronim çështjen e kolonializmit të botës arabe e islame në legjendë!

Sikur të përkryhem me këtë moral dhe të armatosemi me fuqi materiale do ta zhbinim flamurin e qytetërimit nga duart e perëndimorëve të mëdhenj e të degjeneruar.

O vëlla musliman!

Kur të agjërosh Ramazanin, mos harro se Zoti xh. sh. don të të shndërrojë me anë të agjërimit në njeri "të fuqishëm e besnik" dhe ke kujdes që të mos kalojë Ramazani e të ngelish "i dobët e tradhtar"!

O bijtë e Ummetit!

Kur agjëroni, mos harroni se Zoti me anë të agjërimit don t'ju shndërrojë në popull "të ashpër kundër jobesimtarëve e të mëshirshëm ndërmjet vete" (El-Feth, 29) dhe keni kujdes të mos kalojë Ramazani e t'u përngjani njerëzve që i përshkruan Zoti kështu: "E kur t'i shohish ata, trupat e tyre të mahnisin, e kur të flasin, fjalës së tyre i vë veshin. Por ata janë si trungujt e zgavruar e të mbështetur, e çdo zë e mendojnë se është kundër tyre". (El-Munafikun: 4)

RAMAZANI, MUAJI I LIRISË

"Në liri plotësohet adhurimi, kurse me realizimin e adhurimit plotësohet liria". Ahmed ibn Hadravejhi

Liria nuk është ashtu siç e kuptojnë shumica e njerëzve, gjegjësisht nuk përkufizohet me përfitimin e popujve, të drejtat e tyre në udhëheqje e pavarësi sepse kjo është liri politike, e pas saj vijon liria e idologjisë, e popullit, kulturës dhe doktrinëve humane fisnike.

Liria nuk është ashtu siç e paramendojnë shumica e të rinjve, gjegjësisht njeriu të vrapojë pas epsheve dhe dëfrimeve të tij, të hajë e të pijë si të dojë si dhe të realizojë çdo gjë që dëshiron. Kjo liri prezenton formën e kaosit në një anë dhe robërinë e urrejtur në anën tjetër.

Kjo liri prezenton formën e kaosit sepse s'ka në botë liri absolute e të pakufizuar me ligj ose sistem, bile çdo gjë në botë zhvillohet sipas ligjit të posaçëm sistematizues.

Liria e individit mbrohet vetëm nëse përkufizohet me disa rregulla me qëllim që të mbrohen liritë e të tjerëve, dhe nga kjo urtësi dalin ligjet, kushtetutat, sistemimet dhe rregullat. Për shembull, ligji i trafikut në metropolet e mëdha, ku udhëzohesh nëpër rrugë me shenjat udhëzuese të komunikacionit, ligji i qetësisë së përgjithshme, i cili pengon të bërtasish natën në rast të kalimit nëpër lagjet e banuara; ligji i mbrojtjes së pavarësisë, gjegjësisht s'mund të propagosh ide që e rrezikojnë sigurinë e paqes në shtet...

A mund të kërkohsh kontratën paqësore me armikun gjersa populli yt gjendet në kulm të luftës? A mund të zhvillosh tregti me armikun apo t'ia dorëzosh prodhimet e vendit tënd pa kurrfarë dënimi që shpeshherë përfundon me ekzekutim?

Plotësimi i lirisë ndonjëherë realizohet me ndalim, p.sh. të sëmurit të cilit i ndalohet ushqimi i dëmshëm, i kufizohet përkohësisht liria e ushqimit për shkak të shërimit ndërsa kriminelit burgoset përkohësisht për të kuptuar se si ta shfrytëzojë më vonë lirinë e vet, në mënyrë të drejtë dhe pa i dëmtuar njerëzit dhe vetveten.

Njeriu nuk jeton i vetëm por është pjesë e shoqërisë së bashkuar dhe kështu nëse dëmtohet ai dëmtohet edhe shoqëria. Për këtë, Muhammedi a.s. ka dhënë një shembull të bukur rreth një grup njerëzish që kanë lundruar me anije. Disa prej tyre kanë qenë në pjesën e lartë kurse të tjerët në pjesën e ulët të anijes. Pasi që ata të cilët ishin poshtë e merrnin ujin prej atyre që ishin lartë, thanë: "Pse nuk fundosemi e të marrim ujin drejt nga deti?" Muhammedi a.s. tha: "Sikur t'u lejonin të veprojnë sipas dëshirës së tyre do të fundoseshin të gjithë, e nëse shpëtonin ata, do të shpëtonin të gjithë". Ky është një shembull i mirë nga mësuesi më i madh i

njerëzimit, i cili përkufizon lirinë individuale që nuk dëmton askend dhe lirinë që dëmton dhe shkatërron shoqërinë nëse eventualisht aplikohet.

Sa i përket robërimit, mund të themi se liria plotësohet atëherë kur nuk të robëron ndokush që është njeri sikur ti. Liria individuale, në të cilën mbështeten disa njerëz, prezenton robërimin e urrejtur nga ana e njeriut që është sikur ti dhe kaosin e parimeve jetësore. Nëse mbi njeriun dominojnë kënaqësitë e epsheve dhe jeta e shfrenuar, atëherë ai shndërrohet totalisht në rob të kënaqësisë, sepse jetën e tij vetëm ajo e dirigjon. Në këtë rast ai vepron siç dikton kënaqësia epike dhe s'mund ta kundërshtojë.

Çfarë lirie është kjo kur gjërat e pavlefshme e shndërrojnë njeriun në rob?! Sikur të vlerësohej njeriu sipas sasisë së plotësimi të epsheve, atëherë shtaza do të ishte më e vlefshme!

Shtazët vrapojnë pas kënaqësisë së pakufizuar e të paqëllimtë, kurse njeriu sado që orvatet t'i plotësojë kënaqësitë e veta, përsëri do të gjejë pengesa në rrugë. Pra si mendoni ju, a mund të paramendojë ndokush se shtaza që nuk hasë në pengesa është më e lirë se njeriu dhe më e lumtur?!

Kur ndjek ndokush ndonjë vajzë apo këngëtare, a mund të paramendojë se është i lirë nga dominimi i tyre? A nuk e shoh atë si rob të çastit, të zënë peng e të humbur?

Qëllimet më të larta në jetën e tij varen nga dashuria e larguar apo nga dëshuria e trupit të ndaluar?

A ka robëri më të keqe se ajo që nuk e lë njeriun të lirë në dashuri ose urrejtje, në vazhdim ose ndalim, në kënaqësi ose hidhërim apo në qetësi ose huti?

A mund të supozojmë se është i lirë ai që jepet pas pijeve dehëse derisa të dëmtohen nervat, shëndeti, mendja dhe dinjiteti i

tij? A ka diçka më neveritëse se robërimi nga pija vrasëse dhe helmi shkatërrues?

Kështu mund ta gjykosh atë që dorëzohet krejtësisht para pasurisë e pozitës dhe fanatizmin e udhëheqësit. Çdo njeri i dorëzuar para këtyre gjërave, shndërrohet në rob të mposhtur si dhe çdo epsh që sundon mbi veprat dhe sjelljet e tij, e shndërron në rob të përhershëm. Kjo gjendje përshkruhet shumë bukur në Kur'an: "A e ke parë ti (Muhammed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin?" (El-Xhathije: 23)

Dëshirat e njerëzve të tillë kanë karakteristika hyjnore... A nuk është Zot ai i cili adhurohet, i nënshtrohen, i frikohen dhe i luten? A nuk janë ithtarët e epsheve nën dominimin e dëshirave të tyre kegase nuk mund t'i hidhërojnë e as t'i refuzojnë?!

Robërimi nuk paraqitet vetëm në formë të lidhjes apo të burgut sepse këto janë llojet më të lehta të tij dhe me afat shumë të shkurtë.

Robërimi i vërtetë formohet nga tradita e përditshme që dirigjon, epshi që sundon dhe kënaqësia që adhurohet... Liria nuk është në transferimin prej një vendi në një vend tjetër por ajo është në dominimin mbi epshet tuaja dhe në dallimin e të mirës ndaj së keqes.

Liria e vërtetë është që të mos bëhesh rob i shprehisë së përditshme dhe të të mos mposhtë epshi. Në këtë kuptim muslimanët e devotshëm kanë qenë plotësisht të lirë sepse feja i ka liruuar shpirtat e tyre nga ambiciet, epshet dhe dëshirat e dëmshme, i ka lidhur shpirtat e tyre me Allahun, xh.sh. Krijuesin e gjithësisë dhe jetës kurse dëshirat e tyre i ka kufizuar vetëm me dëshirën e Tij. Zoti xh.sh. është i Vërtetë, burim i të mirës, dashurisë dhe mëshirës. Njeriu lirohet nga atributet e urrejtura vetëm në rastë se dominojnë mbi te: e vërteta, mirësia dhe mëshira. Nëse njeriu obligohet të robërohet nga ndonjë ide, doktrinë apo krijesë,

atëherë për të më mirë do të ishte sikur të bëhej rob i të Vërtetës se sa i të keqes. Ata të cilët i robëron doktrina njerëzore që e përfiton lartësinë e saj nga Zoti, janë më të mirë se ata të cilët i robëron doktrina e pashmërtë që rrjedh nga djalli. Ata të cilët i nënshtrohen Allahut xh.sh. dhe i respektojnë urdhërat e Tij janë më të mirë, më të përkryer dhe më të mençur se ata të cilët i nënshtrohen femrës, gotës, pasurisë ose epshit, gjegjësisht respektojnë urdhërin e njeriut që gabon apo qëllon, lartësohet apo mposhtet, bën mirë ose keq...

A nuk vëren, së bashku me mua, pas gjithë kësaj, marrinë e disa përparimtarëve që refuzojnë të thirren ashtu siç i kanë thirrur etërit e tyre, si Abdull-llah (Rob i Zotit) ose Abdulxhevad (Rob i Bujarit), kurse në të kundërtën lejojnë të atribuohen me "robëri"?! A nuk i sheh ata të cilët refuzojnë robërinë nga fuqia e të cilit nuk mund të largohen kurse pranojnë robërimin e epshit më të urryer e më të poshtër? A nuk sheh se ata kanë nevojë për keqardhjen tënde më tepër sesa të nxisin në shpirtin tënd marrinë dhe mohimin?

Me këtë koncept preciz të lirisë dhe robërimit e presim Ramazanin si muaj të "lirisë" kurse agjërimin si shkollë ku diplomojnë të lirët me plotkuptimin shkencor të fjalës.

Në Ramazan ka uri, etje, kufizim dhe ndalim, por edhe shëndet dhe lirim nga robërimi; në të ka revolucion kundër robërimit të ushqimit e pierjes, shprehisë e jetës monotone...

Revolucioni kundër robërisë është atributi i parë i të lirëve.

Në Ramazan ka abstenim vullnetar nga kënaqësia dhe pikërisht kjo gjë paraqet lirinë. Liria e dëshirës është të veprosh sipas mendjes tënde e jo sipas epsheve dhe emocioneve, si dhe ta ndalosh veten nga ajo që mund ta realizosh. Vetëm në këtë rast ke dëshirë të fuqishme, epi të dobët, i kontrollon dëshirat tuaja dhe nuk dështon mendja yte para fuqisë së epshit tënd. Ai që atribuohet kështu, korrë fitore në çdo betejë.

Shiko tregimin për mbretin Talut, i cili ndaloi ushtarët e vet të pijnë ujë nga lumi, edhe pse ishin të etur e të rraskapitur, mirëpo vetëm një numër i vogël e respektoi urdhërin e dhënë dhe ky numër ngadhënjeu për shkak se ishin dinjitozë në përcaktimet e tyre:

"E kur doli (prej qytetit) Taluti me ushtrinë, tha: 'Allahu do t'ju sprovtojë me një lumë, e ai që pi prej tij, ai nuk është me mua, e kush nuk e shijon atë, ai është me mua, përveç atij që me dorën e vet e pi një grusht!' Mirëpo, me përjashtim të një pakice prej tyre, të tjerët pinë nga ai. E kur e kaloi ai (Taluti) atë së bashku me të edhe ata që ishin besimtarë thanë: 'Ne sot nuk kemi fuqi kundër Xhalutit dhe ushtrisë së tij!' Por ata që ishin të bindur se do ta takonin Allahun xh.sh. thanë: 'Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha!' Allahu është me durimtarët. E kur i dolën përballë Xhalutit dhe ushtrisë së tij, thanë: 'Zoti ynë! Na dhuro durim, na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo kundër pabesimtarëve!' (El-Bekare: 249-250)

Kështu, triumfuan ndaj tyre pasi që dominuan mbi nevojat e tyre.

"E ata, të cilët luftuan për hir Tonin, Ne me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se Allahu është në krahun e besimtarëve". (El-Ankebut: 69)

Gjatë Ramazanit, adhurimi ndaj Zotit është i plotë!

Sa më të lirë të jenë njerëzit, aq më shumë do ta adhurojnë Zotin!

Këta njerëz nuk robërohen nga këngëtarja, epshi, pasuria, kënaqësia, ambicia dhe shqetësimi, bile as që i kaplon frika apo drithma.

Adhurimi i Zotit i ka çliruar nga çdo frikë pos frikës nga Ai: "Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë

(në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje. (Ata janë ata) të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde në jetën e dynjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim dhe xhennet). Premtimet e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, kjo është sukses i madh". (Junus: 62-64)

Kështu, ata refuzuan çdo adhurim pos atij të Allahut xh.sh. dhe u shndërruan në zotërues të epsheve, fituan liri të vërtetë e moral fisnik dhe në zemrat e tyre u pasuruan...

Pasha jetën time, kjo është liri e madhëruar! Me të drejtë ka thënë Muhammedi a.s.:

"Pasuria nuk është në pronën e gjerë, por në shpirt."

Sa e mirë është thënia e Ibn Ataull-llahut: "Ti je i lirë nëse largohesh nga diçka, e nëse jo, atëherë bëhesh rob i saj".

Nga e gjithë kjo që u theksua mund të kuptohet urtësia e madhe e thënies së sufistit të njohur Ahmed ibn Hadravejhut: "Në liri plotësohet adhurimi, kurse me realizimin e adhurimit plotësohet liria".

Gjatë Ramazanit njeriu largohet nga paedukimi i urrejtur, fjala fyese, sjellja e turpshme... Sa e ëmbël është kjo liri!

Ti je i lirë në sjelljen fisnike dhe nuk dërgohesh nëpër gjyqe, nuk burgosesh dhe nuk e humbë meritën e pozitës!..

Ti je i lirë në fjalën fisnike, nuk obligohesh të kërkosh falje, nuk qortohesh dhe nuk pendohesh! Ti je i lirë në bashkëpunim me të tjerët, nuk kritikohesh, nuk flitet për tradhtinë tënde dhe nuk je i dyshimtë!

O vëlla besimtar!

Ky Ramazan na mëson lirinë e plotë me urinë e tij, etjen, kufizimin dhe ndalimin... A s'e dëshiron lirinë e tillë, që buron nga uria dhe ndalesa?

Eja pra me mua e të fluturojmë në horizontet e lirisë! Eja me mua e të largohemi nga bota e robërve!

Eja me mua e të shohim se si jetojnë robërit në botën e adhurimit!

A mendon se politikanët e mëdhenj, që i dirigjojnë çështjet e botës janë të lirë? A nuk sheh se janë robër të ambicieve të tyre politike!

Si të bëhet bota e lumtur kur robërit e udhëheqin?

A mendon se ata të cilët e udhëheqin popullin pa dëshirën e tij janë të lirë? A nuk i sheh se janë robër të epsheve dhe lakmisë? Si mund të jetë populli i lumtur kur robërit e udhëheqin?

A mendon se të gjithë popujt që anojnë nga epshet e lira janë të lirë nga çdo adhurim? A nuk sheh se janë viktimë e pavetëdijes dhe shprehisë vrasëse? Si mund të zgjohet një popull që nuk është çliruar nga prangat e robërisë?

A mendon se "përparimtarët" që nuk agjërojnë janë të lirë në mendime e ide? A nuk sheh se mvaren nga kënaqësia e pafrenueshme dhe se janë robër të epshit të pangopur? Barku dhe epshi i tyre i kanë privuar nga bota e të lirëve dhe nga atributet e luftëtarëve! Si mund ta paramendojnë lirinë kur mendja e tyre është nën dominimin e epshit?

Ata janë robër me rroba të të lirëve! T'i cekim të lirët e botës së të lirëve!

A nuk të kujtohet dita kur i erdhi Muhammedit a.s. liria, gjegjësisht liria e plotë e shariatit të Zotit, i çliroi arabët dhe i shndërroi në udhëheqës të botës?

A nuk të kujtohet liria e tyre në mendime gjersa Umeri i tha (Haxherul-Esvedit) gurit të zi: "Pasha Zotin, e di se je vetëm gurë, nuk dëmton e as që ka dobi prej teje. Sikur të mos e shihja të Dërguarin e Zotit se të puthë, nuk do të puthja asnjëherë".

A nuk të kujtohet se përhapja e Islamit ishte mëshirë për popujt, çlirim dhe shkatërrim i prangave...

Ata u shndërruan në popuj më të mëshirshëm dhe më të singertë në bartjen e flamurit të lirisë gjersa një i Perëndimit brohoriti: "Historia nuk ka parë pushtues më të mëshirshëm se arabët"! A nuk të kujtohet se u liruan nga robërimi i pasurisë aq shumë saqë të pasurit, gjatë jetës e shpërndanë tërë pasurinë e tyre. Kur e pyeti Muhammedi a.s. njërin prej tyre se çka i ka lënë familjes së tij, ai është përgjigjur: "Zotin dhe të Dërguarin e Tij".

A nuk të kujtohet lrimi i tyre nga frika e vdekjes dhe dashuria e jetës gjersa komandanti i tyre, Halidi u tha armiqve: "Ju solla njerëz që e duan vdekjen ashtu siç e doni ju jetën!"

Po, vëllai im, ti e kujton gjithë këtë!

Pra, të mësojmë prej Ramazanit lirinë që të jetojmë të lirë në këtë botë dhe ta mësojmë botën se si është liria: "Ju jeni popull më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun." (Ali Imran: 110)

FILOZOFIA DHE SEKRETET E AGJËRIMIT

"Agjërimi paraqet burrërinë e proklamuar dhe dëshirën e lartë".

Kjo është mbrëmja e dytë e këtij Muaji fisnik, në të cilin njerëzit zakonisht qëndrojnë deri në mëngjes, përgatisin ushqim gjersa e kalojnë nivelin e rëndomtë dhe përjetojnë gëzim dhe hare. Këto forma mund t'i plotësojnë dëshirat e disa fetarëve, që i konsiderojnë si argument për thellimin e Islamit në zemrat e muslimanëve, por ngelin në këtë kufi sepse e pranojnë realitetin e agjërit në bazë të urisë ditore, realitetin e fisnikërisë me pagesat e iftarit dhe syfyrit kurse realitetin e devotshmërisë me ndriçimin e minareve dhe mbushjen e xhamive me njerëz.

Në realitet e vërteta e agjërit nuk ndikon në mjedisin e disa njerëzve dhe për këtë vendosin të mos agjërojnë, pa ndier kurrfarë faji ose mëkati, bile ndonjëherë hanë gjatë ditës së agjërit publikisht pa kurrfarë turpi ose shqetësimi.

Sekretet e agjërit

Sikur të ishte agjërimi traditë atëherë sipas edukatës shoqërore, duhej ta respektonim më tepër sesa e respektojmë tash për shkak të nderimit të popullit dhe traditës së tij.

Pra në ç'mënyrë ta respektojmë pasi që është edukatë shpirtërore e popullit që mëson prej agjërit ngritjen mbi epshet, depërtimin në horizontet e mirësisë dhe largimin nga materja, gjegjësisht shoqëria fiton lumturinë e saj?!

Kështu, agjërimi është vegël për edukimin e dëshirës stabile të popullit sepse agjëruesi nuk dominon vetëm mbi kënaqësinë e lejuar por edhe mbi ate të ndaluarën; fiton shprehje të largohet vullnetarisht nga ushqimi e pija që më vonë të mos ndiej vështirësi në rast obligimi.

Agjërimi është obligim praktik i Islamit të mëshirshëm për të gjithë muslimanët; hanë e pijnë në një kohë, nuk dallohet barku prej barkut e as goja prej gojës; ndien urinë edhe ai që se ka ndier para Ramazanit si dhe përjeton vuajtjet e varfërisë dhe të skamjes edhe ai që s'i ka përjetuar më parë.

Pasha jetën time, a ka në botë socializëm praktik që i trajton njerëzit në mënyrë të barabartë, si në skamje ashtu edhe në bollëk, ashtu siç është shoqërorizimi i agjërimit gjatë Muajit të Ramazanit?!

O agjërues besimtarë, Ramazani është largim nga epshi e kënaqësia, lartësim shpirtëror dhe liri shpirtërore. Sa bukur do të ishte sikur i tërë viti të ishte Ramazan, nëse ky është koncepti i agjërimit!

Ramazani është muaji i burrërisë së proklamuar që dominon mbi instinktet dhe i dëshirës së lartë që funksionon vullnetarisht. Sa mirë do të ishte sikur Muaji i Ramazanit ta bashkonte gjithë popullin e të mos mbetet askush me burrëri të dështuar dhe me dëshirë të parealizuar! Sa mirë do të ishte sikur Ramazani t'i bashkonte njerëzit me agjërimin që përmban në vete burrëri të proklamuar dhe dëshirë të lartë!

Ramazani është varfëri e obliguar sepse të gjithë njerëzit në të janë të barabartë, ndiejnë vuajtje të njëjta që dalin nga realiteti objektiv e jo nga imagjinata iluzionare. Nga vuajtjet lindë mëshira kurse nga mëshira drejtësia! Sa e bukur do të ishte jeta sikur të gjithë të kishin vuajtje dhe ndjenja të njëjta!

Sa e bukur do të ishte koha edhe sikur të ishte krejt Ramazan, ngase ai (Ramazani) i realizon gjërat më të rëndësishme në shoqëri: barabarësinë dhe rehatinë!

Nëse Ramazani është përkryerje, burrëri, edukatë e dëshirës dhe socializëm praktik, atëherë a nuk e shpallin publikisht muslimanët që nuk agjërojnë zhytjen e tyre në epshe, largimin nga

burrëria, dështimin në mejdanin e dëshirës dhe luftimin kundër socializmit praktik? A e fitojmë të drejtën që joagjëruesit e rritur t'i quajmë "fëmijë të rritur", kurse fëmijët agjërues "të rritur të vegjël?"

O fëmijët e mi të vegjël dhe o vëllezër të rinj që e përjetoni vuajtjen e urisë, vapën e verës dhe vështirësinë e etjes! Ju agjëroni së bashku me prindërit tuaj dhe e vërtetoni burrërinë dhe dëshirën tuaj!

Ju lumtë, sepse vatani me ju do të fitojë e jo me ata të cilët dështuan para se të hynë në mejdanin e luftës!

O vëlla besimtar!

Nëse Ramazani është ashtu siç u theksua, atëherë e drejta jonë është të pyesim se a agjërojmë me të vërtetë këto ditë apo a i përjetojmë vuajtjet e urisë në ditët e Ramazanit e t'i mënjanojmë nga ato që i përjetojmë gjatë tërë vitit?

A e ndalojmë ushqimin e trupave tanë që t'i mbrojmë organet tona nga dëmtimi dhe armiqësia? A ndojmë në agjërim lartësinë e shpirtit tanë ashtu që të mos veprojmë siç kemi vepruar para Ramazanit?

Muhammedi a.s. përgatitej para çdo Ramazani, jo me ushqim e pije as me zbukurim e veshje, por me adhurim dhe devocion, bujari dhe shpirtgjërësi, kështu që para Zotit xh.sh. shndërrohej në rob respektues, para njerëzve në peygamber të urtë, kurse para vëllezërve dhe fqinjëve të tij në mirëbërës dhe bujar aq shumë sa që disa shokë të tij thonin se gjatë Ramazanit ishte më bujar se kurdoherë më parë...

Ashtu vepronin edhe shokët dhe pasardhësit e tij. Ramazani për ta ishte koha kur shijonin erërat e parajsës (xhennetit), fluturonin besimtarët në qiejt e të vërtetës dhe ngriheshin zërat e falësve të namazit kundër tiranëve keqtrajtues.

Pse nuk e përjetojmë Ramazanin ashtu siç e përjetuan Pejgamberi dhe paraardhësit tanë? Pse nuk e shndërrojmë në muaj të mirësisë ashtu që jeta jonë të lulëzojë vetëm me mirësi, begati dhe lartësi shpirtërore?

Pse nuk e shndërrojmë Ramazanin në muaj të luftës kundër dobësisë, injorancës, epsheve tona, kaosit tonë dhe kundër çdo mëkatari e tirani në botë?!

O ju agjërues!

Ju jeni në luftë me epshet tuaja për shkak të grindjes mes materies dhe shpirtit dhe duhet të keni kujdes që të mos dështoni; keni kujdes që të mos keni uri ditën për t'i mbushur barqet natën; keni kujdes që të mos i ushqeni duart, sytë dhe gjuhën tuaj pas agjërimit me mëkate, gënjeshtra e sharjel.

Keni kujdes që të mos jeni aktivë në veprat e këqija dhe përtacë në adhurim! Keni kujdes prej të gjitha këtyre gjërave sepse janë vepra të djallit e jo të Rrahmanit (Zoti xh.sh.).

Shpejtoni në përkushtim! Bëni vepra të mira!

Shijoni erërat e xhennetit! Çoni sytë përpijetë kah qielli!

Ngreni shpirtrat tuaj nga kjo botë!

Përkujtoni gjithmonë thënien e Muhammedit a.s.: "Shumë agjërues nuk fitojnë prej agjërimit të tyre pos urisë dhe etjes", ose: "Agjërimi është mburojë dhe nëse e nxitë ose e sulmon ndokush agjëruesin le të thotë: 'Unë agjëroj, unë agjëroj'".

O Zot, na bën prej agjëruesve të pranuar!

RAMAZANI, MUAJI I MIRËBËRJES

Para pak çastesh përfunduat iftarin dhe falënderuat Zotin xh.sh. për ushqimin pas urisë dhe etjes.

Iftari është njëri prej dy gëzimeve që i ka theksuar Muhammedi a.s.: "Agjëruesi ka dy gëzime: në iftar dhe në takimin me Zotin e tij."

Gëzimi i përbashkët nga ushqimi dhe freskimi zakonisht realizohet në mbrëmjet e Ramazanit sepse familja vështirë bashkohet në ushqim e haje pos në Ramazan, bile nëse ndokush mungon nga familja, mungesa e tij ndihet më së shumti në ditët e Ramazanit.

Ju, o agjërues, në çdo mbrëmje të Ramazanit përjetoni lumturi të papërshkruar, i falënderoheni Zotit xh.sh. dhe kërkoni prej Tij që ajo lumturi të vazhdojë; pra si e paramendoni vazhdimin e këtyre begative dhe si i falënderoheni?

Falënderimi për mirësitë nuk shprehet vetëm me gjuhë por duhet të punosh që edhe vëllezërit tu, të cilët jetojnë një jetë në skamje, të të shoqërojnë në ato mirësi. Sa të varfër ka që janë më të zgjuar e më të mençur se të pasurit mirëpo ashpërsia e shoqërisë dhe mosinteresimi shtetëror ua destinoi botën e mjerimit dhe të problemeve elementare.

Pasi që mëshira për ta është e obliguar jashtë ditëve të Ramazanit, atëherë gjatë këtij muaji bëhet edhe më e obligueshme.

Pasi që shoqatat humanitare obligohen t'u ndihmojnë dhe t'ua fshijnë lotët, pikëllimet dhe mjerimet e tyre, atëherë muslimanët janë më të obliguar për t'i bërë të lumtur e t'u ndihmojnë.

O ju njerëz, a nuk mendoni se numri i njerëzve të tillë është shumë i madh?

A nuk mendoni se ata në shoqërinë tonë të ashpër e të vrazhdë gjenden në çdo lagje, treg, rrugë, fshat...?

Mos mendoni se të gjithë ata të cilët trokasin në dyert tuaja dhe të cilët ju bezdisin me insistimet e tyre nëpër rrugë janë të varfër sepse shumica janë ekspertë në fjalë. Të mjerë dhe të varfër janë ata të cilët nuk mund t'i ushqejnë fëmijët me rrogat e tyre, gratë që s'kanë gjë në vatrën e tyre, jetimat, refugjatët e ikur të cilët për shkak të politikës diskriminuese, tradhtisë apo faktorëve të tjerë e humbën pasurinë, u poshtëruan, u shpërndanë nëpër rruzullin tokësor dhe erdhën te ne që të kërkojnë lëmoshë për jetë.

Për ta sot duhet të kujtoni. Nuk them që t'u jepni lëmoshë apo të bëheni zemërgjerë sepse këto janë sjellje njerëzore, por them: "fshini mëkatet tuaja dhe të tyre me ndjenjat e vëllazërimit, lidhjet fetare, mëshirën dhe afërsinë fqinjësore".

Sikur të mos ishte vrazhdesia e shoqërisë, nuk do të jetonin në mjerim të tillë. Nëse ata ndjejnë idhëtinë e jetës një herë jashtë Ramazanit, atëherë e ndjejnë shumë herë gjatë këtij muaji.

O ju njerëz, ata janë fqinj tuaj sepse në çdo lagje keni një ose më shumë familje të varfëra. Paramendone mjerimin e tyre kur ju shohin se si hyni në shtëpitë tuaja me lloj-lloj pemë, perime e ëmbëlsira, kur e ndjejnë erën e mishit të pjekur dhe të gjellave për çdo mbrëmje dhe kur i shohin fëmijët tuaj që dalin të ngopur në rrugë për të luajtur. I ati i tyre ndien dhembje në gjoks, nënës i rrjedhin lotët, kurse fëmija qanë e vajton nga uria.

Kështu ju ushqeheni çdo ditë kurse ata kalojnë natën të uritur...

Njoh një prind që ishte i pasur kurse fëmijët e tij ishin mësuar me ushqim të mirë dhe veshmbathje luksoze, mirëpo, për fat të keq pas një kohe përjetoi çastet e vështira të mjerimit. U afrua Ramazani kurse ai s'kishte të jep atë që e jepte më parë dhe kështu, për shkak të turpit nuk dille të kërkojë prej njerëzve lëmoshë apo

sadaka. S'kishte mundësi t'i ofrojë familjes së vet diçka për të ngrënë pos djathit, fasules dhe ullirit.

Fëmijët e tij duruan ditën e parë dhe të dytë mirëpo në të tretën, fëmija i vogël i tha: "O baba, na e mbytë barkun djathi dhe ulliri, ne agjërojmë dhe kemi nevojë për ushqim të mirë e lëngje freskuese në këtë vapë dhe do ta humbim vetëdijen nga erërat e gjellërave të fqinjve tanë. Pse nuk na ushqen ashtu si i ushqen fqiunë fëmijët e tij dhe ashtu si na ushqejshë më parë?" Kështu, fëmijës i pikuan lotët, kurse i ati doli në një vend të errët të shtëpisë dhe filloi të qajë, sepse nuk dëshironte që zemrat e fëmijëve të tij ta përfetojnë mjerimin e skamjes nga vrazhdsia e njerëzve dhe dredhia e shoqërisë.

O ju agjëruet të pasur! Ju keni gjellëra të ndryshme e të këndshme për çdo mbrëmje. Diçka prej tyre mund ta ushqejë të uriturin, t'i gëzojë të mjerët dhe t'i fshijë pikëllimet. Pra, a mendoni për fqinjët dhe të afërmit tuaj? A mendoni që të ndani vetëm një gjellë prej gjellërave tuaja për familjen, mjerimin e së cilës e njeh vetëm Allahu xh.sh.?

Pasha Atë që e ka obliguar agjërimin për ta siguruar barabarësinë njerëzore dhe mirëbërjen ndaj të mjerëve e të varfërve, sikur çdo agjëruet të ushqejë ndonjë agjëruet të varfër dhe sikur çdo familje e pasur të ushqejë ndonjë familje të varfër, nuk do të ekzistonte në shoqërinë tonë asnjë i mjerë, i varfër ose fatkeq. Ramazani do të ishte muaj i begatisë së pafundme dhe ne do të ishim Ummeti më i mirë në botë!

O agjëruet, ndihmoni fqinjët tuaj, të afërmit dhe vëllezërit refugjatël

Keni kujdes që të mos e harroni mirëbërjen ndaj tyre, lumturinë e tyre dhe shfrytëzimin e përbashkët të begative të Zotit xh.sh.

O ju agjërues, kur të mblidheni me familjet tuaja rreth sofrave tuaja plot me ushqim e pije kujtoni urinë e zorrëthatëve dhe vuajtjet e njerëzve si dhe binduni se Zoti xh.sh. nuk do ta pranojë agjërimin e as adhurimin tuaj, po qe se afër jush jetojnë njerëz të uritur që mund t'i ushqeni dhe të mjerë që mund t'i gëzoni!

Muhammedi a.s. thotë: "Nuk më beson mua ai i cili fle i ngopur dhe e di se fqiu i tij është i uritur." O Zot, të lusim që të na dhurosh të mira të llojllojshme dhe të falënderohemi për begatitë që na i ke dhuruar; na mundëso të bëjmë vepra të mira dhe të hyjmë në parajsë me mëshirën Tënde e të jetojmë me robërit e devotshëm!

NDIKIMI I ADHURIMIT (IBADETIT) NË EDUKATËN E POPULLIT

Popujt që duan të bëhen të famshëm dhe fisnikë ndjejnë nevojën për një edukatë të posaçme për fëmijët e tyre të cilët më vonë do ta mbrojnë ideologjinë dhe mesazhin e tyre.

Karakteristikat më të rëndësishme të kësaj edukate janë: "fuqia", "dashuria" dhe "modestia".

Me termin "fuqi" nënkuptojmë fuqinë e shpirtit dhe të mendjes; me termin "dashuri" nënkuptojmë dashurinë ndaj fëmijëve të popullit dhe bashkëpunimin e njohjen e ndërsjellë me fëmijët e njerëzimit; me termin "modesti" nënkuptojnë eliminimin e dallimeve klasore, gjegjësisht të mos ketë i pasuri përparësi ndaj të varfërit për shkak të pasurisë, njeriu i shtetit ndaj atij të rrugës për shkak të pozitës së tij dhe të mos mburren njerëzit me prejardhjen familjare, rrobat apo pasurinë, por me punë të mira.

Nëse edukata e popullit përqëndrohet në këto tri karakteristika, atëherë do të ketë rini e cila do ta mbrojë nga sulmet e njerëzve

qëllimkeqë dhe nga rreziku i dekadencës dhe devijimit të brendshëm shtetërorë.

Për fat të mirë, sheriatu ia ka siguruar popullit tonë këtë lloj edukate për të formuar një rini të tillë, edhe atë në bazë të parimeve fetare islame që i ka caktuar. Namazi, agjërimi, haxhxi dhe zekati në realitet janë mënyra për edukimin e shëndoshë që është i nevojshëm për jetën e çdo populli nëse synon të jetojë i përkryer e fisnik.

O vëlla i singertë, eja me mua e t'i analizojmë këto tri elemente islame dhe të shohim se a kemi nevojë për to që të formojnë gjeneratë që i përballon kohës me fuqi, lartësi dhe edukatë fisnike? Nëse e analizojmë elementin e fuqisë në besimin islam do të shohim se abdesti është fuqi për trupin dhe energji për shpirtin dhe se qëndrimi i përbashkët i gjithë muslimanëve para Zotit xh.sh. në një drejtim është fuqi që vërteton qëllimin unik, pastaj përgatitja e rrugës së drejtë dhe ngritja e kokës përpjetë, etj.

A nuk sheh se hyrja në namaz me himnin hyjnor të përhershëm: "Allahu Ekber (Zoti është më i madh)" paraqet fuqinë e shpirtit, frymës dhe masës së popullit që ndien se Zoti është më i madh prej çdo të madhi, më i madhëruar dhe më i fuqishëm në botë se çdokush tjetër që konsiderohet i fuqishëm dhe i madhëruar? Pastaj a nuk shohim se thënia e besimtarit në namaz: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm në Ty mbështetemi" paraqet betimin e fuqisë së besimtarit para Zotit se vetëm Atë e adhuron dhe vetëm në Të mbështetet? Në këtë mënyrë besimtari forcohet me Zotin para dobësisë së vet në jetë dhe provokimit të epshit.

Pastaj qëndrimi në radhë të drejta pas imamit për të dëgjuar leximin e Kur'anit, ligjëratat ose për t'u falur gjithashtu prezenton fuqinë e bashkimit të popullit, fjalën e përbashkët, zemrat e bashkuara dhe dominimin e respektit dhe disiplinës.

Çfarë fuqie mund të jetë më e mirë për popullin se kjo e namazit që ndjehet në shpirtin e muslimanit pesë herë në ditë?

Nëse e analizojmë agjërimin do të vërejmë se agjëruesi vullnetarisht u nënshtrohet vuajtjeve nga uria, etja e lodhja. Kjo fuqi e dëshirës së tij për t'u përballuar vështirësive në jetë nuk mund të krahasohet me asnjë fuqi tjetër si dhe nuk e njeh dështimin apo disfatën.

Nëse e analizon haxhxin, do të kuptosh se lundrimi mbi det, hipja në tren e automjete tjera, ecja nëpër shkretëtirë, lakuriqësia e kokës, gjoksit, krahëve dhe këmbëve, qëndrimi nën diell, tavafiri rreth Qabes dhe shpejtimi mes Safasë dhe Merves paraqesin fuqinë e shpirtit, fuqinë e trupit dhe fuqinë e dëshirës. A ka ndonjë edukatë shoqërore që është më e mirë dhe më fisnike se kjo që i bashkon të pasurit me të varfërit, të madhin me të voglin dhe që e forcon Ummetin aq shumë saqë e anulon dobësinë, dështimin dhe paaftësinë.

Edhe zekati përmban fuqi e dëshirë sepse dhënësi ndanë nga pasuria e tij që e ka grumbulluar me lodhje e vuajtje për vëllezërit e vet, dominon mbi koprracinë dhe dëshirën për grumbullimin e pasurisë.

Ai që jep diçka vullnetarisht nga pasuria e tij e shtrenjtë konsiderohet bujar më i madh. Ky është elementi i fuqisë në besimin islam. Tash të shohim elementin e dashurisë.

A nuk sheh se tubimi i muslimanëve për faljen e namazit është faktor i dashurisë ndërnjerëzore? Ata tubohen në vendin më të pastër dhe me qëllim më fisnik para Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit e Mëshirëbërësit... Pasi i kaplon mëshira e Zotit, atëherë s'ka vend për vrazhdësi, dëm e tirani.

Pastaj shih se si e përfundon muslimani namazin e tij me thënien: "Paqja dhe shpëtimi qofshin mbi ne dhe mbi të

devotshmit e Zotit". Ai në këtë rast përkujton botën e mirësisë dhe vëllezërit e tij si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Kur del prej namazit thotë: "Paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi ju". Ai e fillon namazin me madhërimin e Zotit dhe e përfundon me mëshirë e paqe të përhershme.

Njerëzimi ka shumë nevojë për një fuqi të tillë të mëshirshme që i kaplon edhe popujt e shtypur e të mjeruar në tokë.

A nuk të nxitë ndjenja për uri dhe etje gjatë agjërit që ta rikujtosh botën e uritur e të etshme? A nuk është edukatë praktike e dashurisë pas dështimit të rregullave dhe leksioneve teorike në realizimin e saj?

A nuk është haxhxi dashuri ndaj Zotit xh.sh., Pejgamberit dhe vendit ku lindi thirrja islame?

A nuk është dashuri ndaj njerëzve ngase braktiset shtëpia dhe familja për t'u tubuar në një vend? Përsa i përket elementit të modestisë, unë nuk shoh diçka më të bukur se modestia e muslimanit kur përulet para Zotit xh.sh. Kështu përulen të gjithë muslimanët - nuk ka kokë mbi kokë as shpirt mbi shpirt por të gjithë janë një. Gjatë faljes së namazit në xhami, shpirtit njerëzor i kthehet autoriteti sepse aty të mëdhenjtë e ndjejnë shpirtin popullor, sepse aty takohen me popullin krah për krah e fytyrë për fytyrë. Sheriati në namaz ka caktuar barabarësinë mes njerëzve sepse aty vërtetohet jeta e realtë.

O ju të rinj, a dëshironi fuqi? Ajo përfitohet në bazë të adhurimit të Zotit të Madhëruar dhe përuljes para Tij?

O ju të moralshëm, a dëshironi dashuri? Kjo realizohet në bazë të namazit, agjërit, haxhxit dhe zekatit!

O ju socialistë, a dëshironi barabarësi? Kjo realizohet në bazë të namazit, agjërit, haxhxit dhe zekatit sepse njerëzit barabarësohen, -trupat tubohen dhe duart bashkohen.

O ju reformistë, a dëshironi fuqi për popullin tuaj, dashuri, barabarësi e modesti? Atëherë thirrni në adhurim, nxitne devotshmërinë në popull dhe bëhuni të devotshëm e adhurues!

INSTITUCIONI I ZEKATIT

Ramazani është afër përfundimit dhe ju përgatiteni ta përcjellni me mirësi e mirëbërje. Në kohën e fëmijërisë sime i vëreja njerëzit se si e përcillnin këtë muaj me ndihma e kontribute, gjegjësisht me zekat. Para se të afrohej gjysma e këtij muaji të pasurit i hapnin sënduqet e tyre, e pastronin pasurinë dhe i hapnin dyert e të varfërve me lloje të ndryshme bamirëse si në veshmbathje, ushqim dhe të holla. Sa bujar ishte shpirti i muslimanëve të atëhershëm përplot me bashkëpunim, ndihma dhe kontribute. Ramazani i kishte kapluar zemrat dhe kishte çrrënjësuar urrejtjen, i kishte bashkuar duart dhe eliminuar koprracinë si dhe e kishte kapluar pasurinë, e kishte zhdukur gjendjen e saj statike sepse bartej prej një xhepi në xhep tjetër dhe prej një shtëpie në shtëpi tjetër. Kur vinte festa, fytyrat e njerëzve ishin përplot hare, trupat e tyre të veshur me rroba të bukura dhe duart i zgjateshin njëri-tjetrit me dashuri.

Kështu e shihja lamtumirën e Ramazanit në kohën e fëmijërisë sime dhe nuk e di se a ekzistojnë ende këto tradita të bukura. Jam i bindur se besimi që i nxiste etërit dhe gjyshërit tanë të japin zekatin dhe të shpërndajnë mirësi në Ramazan ende ekziston në shpirtin tonë dhe na nxitë të veprojmë ashtu siç vepronin ata, eventualisht ta përfundojmë Ramazanin ashtu siç e përfundonin ata.

Zekati nuk ka muaj të caktuar në Islam mirëpo ne shfrytëzojmë një rast prej rasteve të adhurimit dhe një mënyrë prej mënyrave të eliminimit të varfërisë e mjerimit.

Zekati në Islam nuk është sadaka (dhënie lëmoshë) e as nafile, por është dhënie e obliguar për të drejtën shoqërore, për lumturinë e shoqërisë dhe për parimin islam që konfirmon se sado që të ketë dallime mes njerëzve në pasuri, përsëri duhet të mbretërojë parimi i përbashkët i nderit njerëzor që e proklamoi Kur'ani: "I kemi fisnikëruar dhe nderuar pasardhësit e Ademit".

Zekati është e drejta e të varfërit që ka aftësi për punë por s'e gjen dot apo s'mund të punojë për shkak të ndonjë sëmurje ose pengese tjetër. Zekati është e drejtë e klasave të nënshtruara në shoqëri për ta shfrytëzuar frytin e mundimeve të tyre, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar në Kur'an: "Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë, për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë, por nuk lypë)."

Është për t'u habitur se njerëzit e sotshëm shkojnë kah socializmi me hapa të shpejtë ngase mendojnë se ky është drejtimi ideal për mbrojtjen e nderit të njeriut edhe atë pas luftërave, revolucioneve dhe zhvillimeve që e ndërtojnë historinë. Njerëzit ende nuk kanë vendim të prerë për kufijtë e këtij socializmi apo për ndonjë mënyrë që e zhdukë mjerimin dhe e realizon lumturinë.

Islami është ai që proklamoi parimin e barabarësisë shoqërore para katërmëdhjetë shekujsh në mënyrë aq të qartë saqë askush s'mund ta mohojë. Pastaj ai caktoi edhe metodën e tij duke e caktuar zekatin si një prej karakteristikave të realizmit socialist. Zekati shumë herë ka realizuar drejtësinë shoqërore dhe ka luftuar dukuritë e mjerimit dhe vuajtjeve në shoqëri.

Si shembull, i Dërguari i Zotit e dërgoi Muadhin në Jemen për ta mbledhur zekatin dhe për ta sjellë në Medinë që t'ua shpërndajnë të varfërve, dhe e porositë kështu: "Po të dërgoj në Jemen për ta mbledhur zekatin nga të pasurit e Jemenit dhe t'ua shpërndash të varfërve", kurse Muadhi i është përgjigjur: "Pasinë

e tubuar nga zekati ta dërgoj pas plotësimit të nevojave të të varfërve derisa nuk mbetet tek unë asnjë i varfër."

Edhe për Umer ibn Abdulazizin i cili i udhëzonte njerëzit ta aplikojnë sheriatin, një funksionar i tij rrëfen kështu:

"I vizitonim njerëzit me sadakatë por askush s'i pranonte".

Mendoj se asnjë shtet socialist bashkëkohor nuk mund të deklarojë se e ka eliminuar varfërinë dhe se nuk pranon ndihmë monetare.

Nëse dëshirojmë ta zhdukim gjendjen e palakmueshme të shoqërisë sonë dhe ta realizojmë barabarësinë njerëzore, atëherë më mirë do të ishte t'i kthehemi zekatit e ta përdorim si armë kundër mjerimit në rrethin tonë, nga vrazhdsia dhe koprracia në një anë dhe mjerimi e skamja në anën tjetër.

A nuk preferohet për ne, pasi që bëjmë përpjekje të shpëtojmë nga kaosi, regresi dhe prapambeturia, që t'i qasemi kësaj metode të siguruar me shariat e të pamohuar?

Zekati është pasuri e madhe që grumbullohet nga shteti e populli për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme, ngritjen e standardit të familjeve të rrezikuara dhe sigurimin e gjërave elementare për çdo qytetar.

Të gjithë jemi të bindur se kemi nevojë për të, mirëpo ankohemi se kemi pak pasuri, gjithashtu edhe shteti, shoqatat reformiste dhe apeluesit e drejtësisë shoqërore ankohen...

Obligimi i zekatit është 2,5 për qind nga pasuria e posaçme, kështu mund të paramendoni se sa është pasuria e Damaskut, sa është zekati vjetor për të, sa mund të ndërtojë spitale, shkolla, fabrika e shtëpi për të varfërit, punëtorët dhe fshatarët dhe sa mund ta ngritë standardin e qindra familjeve për çdo vjet?!

Pse ta humbim gjithë këtë e të ankohe mi?

Pse nuk e shfrytëzojmë këtë rregull të Islamit pasi që kemi nevojë jashtëzakonisht të madhe për të? Me këtë fjalim u drejtohem dy kategorive të popullit, kategorisë që i takon ta jep zekatin dhe kategorisë së udhëheqësve, prijësve dhe reformatorëve.

Sa i përket grupit që i takon ta jep zekatin e që e përjeton obligimin e Ramazanit, lus që t'i besojnë Zotit xh.sh., ta përcjellin rrugën e Muhammedit a.s, ta respektojnë Librin e Zotit dhe ta japin zekatin e plotë aty ku e ka caktuar Islami nëse dëshirojnë ta takojnë Zotin xh.sh. me zemër të pastër e punë të mira. Pasuria juaj, kënaqësitë tuaja dhe fëmijët tuaj nuk ju afrojnë me Zotin, nuk ju shënojnë në histori e as që i hapin zemrat e dashurisë dhe respektit të popullit, por ajo që ju ofron me Të është vepra e mirë. Lumturia e popullit dhe përparimi i vendit tuaj ju shënojnë në histori kurse dhënia e pasurisë që ua ka dhuruar Zoti xh.sh. pa e mbyllur dhe pa e fshehur, ua hapë zemrat e popullit.

Kthejani këtij populli të mjerë të drejtën e tij me pasurinë e zekatit që të shpërbleheni nga Allahu xh.sh., t'ju përmendë historia e t'ju respektojë populli, sepse në të kundërtën do të ballafaqoheni me revolucion shpirtëror që vlon në brendësi, qoftë edhe nga duart e mëkatarëve! A pritni që pushteti t'ua merr atë që ju refuzoni ta jepni ashtu siç veproi Ebu Bekri?

Unë gjithashtu i apeloj grupit të udhëheqësve, prijësve dhe reformatorëve që të themelojë institucion popullor të quajtur "Institucioni i Zekatit" të cilin do ta drejtojnë njerëzit më të zgjedhur e do ta mbikëqyrë shteti që të mos bëhet ndonjë shpenzim i kotë, që do ta realizojë drejtësinë shoqërore dhe përparojë standardin e jetës, arsimit, shëndetësisë dhe moralit.

O ju udhëheqës dhe burra të shtetit, nëse veproni kështu, së shpejti do t'ia siguron popullit tuaj fuqinë, famën dhe autoritetin! Ju jetoni në botën që e organizon dhe realizon barabarësinë mes

njerëzve dhe nuk do të mund t'i mëshironi njerëzit me botën e tyre të organizuar e të drejtë sepse ata ju kanë paraprirë në të kohë më parë, pos nëse shpejtoni dhe e realizoni barabarësinë e Islamit, eventualisht të filloni me organizimin e të ardhurave të zekatit.

Ky është një rikujtim për atë që e do mirësinë dhe që dëgjon me vëmendje!

RAMAZANI FLET

Mesazhi i Ramazanit dërguar Ummetit fisnik O bijtë e Ummetit fisnik!

Erdha tek ju dhe më pritët ashtu siç e pret populli vizituesin fisnik me mikpritje të mirë dhe dashamirësi të sinqertë, kurse disa të tjerë u tallën me mua dhe më pranuan ashtu siç i pranojnë muajt e tjerë të vitit. Unë erdha vetëm t'ju mësoj si të hyni në jetë me armët e fitores!

Zoti i falënderoi popullit tuaj për mikpritjen e bukur dhe e shpërbleu. Zoti i faltë ata që u vonuan pak me mirëbërje, që dështuan në provimin e burrërisë dhe që refuzuan shpirtin dhe simbolin e besimit, nëse besojnë në Zot dhe në të Dërguarin e Tij.

Pasi që vizituesi obligohet ta falënderojë atë që e pret me sinqeritet, atëherë unë ndiej veten të obliguar që t'ju falënderohem me këshilla dhe porosi që do të mjaftojnë për fisnikërinë dhe adhurimin tuaj.

O popull i singertë!

Erdha tek ju pas përfundimit të luftimeve që u zhvilluan gjatë votimeve. Këto luftime ishin të vërteta sepse shkaktuan plagosje, gjakderdhje, intriga dhe armiqësi! Mjerë për ju!

Popujt zhvillojnë luftëra me armiq të tyre dhe i pranojnë të gjitha vuajtjet luftarake për ta kthyer nderin e tyre, t'i shpëtojnë fëmijët, pra pse ju i zhvilluat këto luftëra?

Disa që e ngritën flamurin e luftës do të përgjigjen se ndjejnë obligim ndaj popullit dhe ndaj vatanit! Kjo përgjigje do të ishte e bukur sikur të përputhej me realitetin, sepse unë vëreja të vërteta që nuk përputhen me realitetin si p.sh. ndjekja e të pafajshmëve, falsifikimi i dëshirës së popullit, mbështetja në metodat e kolonialistëve që e privojnë popullin nga të drejtat e veta dhe humbja e dinjitetit dhe autoritetit të popullit.

Pra, e gjithë kjo u realizua nga duart e falsifikuesve! Nëse është parlamentarizmi shprehje e mirësisë, atëherë pse e aplikuan metodën e të keqes? Nëse është për ngadhënjimin e të vërtetës, atëherë pse u mbështetën në fuqitë e të humburve? A nuk është vrasja e njeriut nga të ndershmit trima në mejdan më e mirë dhe më e preferueshme se suksesi dhe fitorja me armën e hajnave dhe horrave?

A u bëhet shërbim nëse akuzohen me fjalë që e njollosin nderin e vendit? A i shërbejnë popullit nëse e mbulojnë dështimin e tyre me rrena, mashtrime, fjalë triviale edhe pse janë të vetëdijshëm për të kundërtën?

A është ky moral? A i harruan leksionet e historisë?

A nuk e kërkoi Aliu hilafetin, mirëpo kur u zgjodh Ebu Bekri u bë një prej më të singertëve ndaj tij? A nuk i lartësoi Halidi flamujt e Islamit mbi fortifikatën e Kisraut dhe Kajserit, mirëpo kur e

revokoi Umeri, vazhdoi të luftojë me sinqeritet si ushtarë i rëndomtë për hir të Allahut, Zotit të botëve?

Nëse refuzoni të bëheni si etërit dhe heronjtë tuaj të pavdekshëm, atëherë pse nuk merrni leksione patriotike të sinqerta prej armiqve tuaj bashkëkohorë? A nuk e udhëhoqi Çerçili popullin e vet deri në fitore, mirëpo kur dështoi partia e tij në votime, ua dorëzoi udhëheqjen shtetërore ngadhënjyese, nuk i akuzoi kundërshtarët për tradhti, as popullin për mosdëgjim, e as që dërdëllisi para popullit se ai e udhëhoqi deri në fitore dhe sikur të mos ishte ai do të humbte?!

Kjo ishte pika e parë o vëllezërit e mi, kurse e dyta ka të bëjë me atë se ju jeni në fillim të pavarësive dhe nuk dini si t'i mbroni, si t'i forconi dhe si t'i dëboni armiqtë tuaj. Ju menduat se pavarësia do të thotë: parlament, ministri, ambasada, civilizim dhe qytetërim! Jo, o bijtë e mi, këto janë vetëm aspektet sipërfaqësore të pavarësisë, kurse parimet e vërteta të saj janë: burrëria, besa, pagjumësia, largimi nga mbështetja në fat dhe në epshe, pra a i plotësoni ju këto?

Udhëheqësit tuaj ua kanë hapur dyert e mëkateve dhe kanë lejuar realizimin e epsheve të shfrenuara, kurse ju jetoni si të doni pa kurrfarë pengese, duke menduar se e tillë është liria, apo, liria është kryesore në pavarësi! Sipas tyre, kufizimi i epsheve është prapambeturi që kundërshton progresin dhe qytetërimin, por deri kur kështu? Si mund të fisnikërohet një popull nëse "zhvlerësohet" morali i të rinjve, i mbushin kafenetë dhe bredhin nëpër rrugë?

Pasuria e shtetit është shkatërruar, pastaj shumica është harxhuar në gjëra të nevojshme e të panevojshme dhe janë ndalur shumë projekte të nevojshme pra, ku është besa?

A është besë që të ardhurat e shtetit të investohen nëpër klube, pronarët e të cilëve vetë deklarojnë se i kanë formuar për ta tubuar klasën sunduese rreth tavolinave me alkool, vallëzim e bixhoz;

pastaj nuk ka mjete për ndërtimin e shtëpive për pleq e as për t'i tubuar ata që e turpërojnë kryeqytetin me rrobat e vjetra duke lypur e jetuar në mjerim të madh.

A është ky besim, o përgjegjës të pasurisë shtetërore?

Kanë depërtuar idetë destruktive në trurin e fëmijëve tuaj, kanë hyrë duart e të huajve tinëzisht në disa institucione dhe janë thelluar intrigat shkatërruese në zemrat e masës suaj, pra ku është syçeltësia e përgjegjësve? Ku është gatishmëria për t'u përballuar këtyre ligësive të huaja, ku është syçeltësia e përgjegjësve për zgjedhjen e funksionarëve të shtetit? A nuk i kanë lënë ndihmësit e kancelarëve dhe bishtat e kolonialistëve të kullojnë nëpër kolltuqe e administrata dhe të marrin rroga të larta edhe pse prezentonin sytë, gjymtyrët dhe armët e kolonializmit?

Zyrat janë mbushur me njerëz të njohur e të afërt që janë të paditur, kurse ata të aftit dhe pronarët e diplomave të larta mungojnë për shkak se nderi i tyre nuk u lejon të poshtërohen!

A s'është kjo largim nga fati i shpirtit? Si mund të përparojë shteti që formohet në bazë të mëkatit apo si fitohet pavarësia që mbështetet në tirani, në afirmimin e të paditurve dhe largimin e besatarëve?

Kjo ishte pika e dytë, o vëllezërit e mi, kurse e treta ka të bëjë me zjarrin që ju kaploi nga të gjitha anët kurse ju jeni të preokupuar me diç tjetër. Ja ku është Palestina e cila është gati të shkëputet nga duart tuaja dhe e cila ua tërheq vërejtjen për ndezjen e zjarrit dhe shpërthimin e vullkanit? Ky është fillimi i luftës mes arabëve të izoluar dhe hebrenjve të armatosur deri në fyt. Ç'përgatitët për t'u ndihmuar vëllezërve tuaj? Ku janë të rinjtë e stërvitur për luftë dhe ku janë prindërit që i përgatisin fëmijët e tyre për luftë? Ku janë të pasurit tuaj që i hapin kapakët e sënduqeve të tyre. Ku janë udhëheqësit tuaj që ndezin në zemrat e popullit zjarrin e zgjuarjes dhe gatishmërisë?

Të mjerët ne, ngase unë shoh vetëm thirrje të kota dhe përgatitje sipërfaqësore të disa fëmijëve e pas kësaj asgjë! Gjumë, tallje dhe shfrenim epsesh kurse armiq të ua japin zjarrin shtëpive tuaja!

Ja ku është Egjipti, i cili për shkak të antagonizmit me Këshillin e Sigurimit, mund të poshtërohet nga të pashpirtët e ta humbë të drejtën e vet, pra ju ç'keni përgatitur për t'i ndihmuar në momentin e duhur?

Vëllezërit tuaj në Maroko, të cilët janë afër tridhjetë milionë, trajtohen si robër, pra ç'është përgatitur për t'ju ndihmuar?

A janë udhëheqësit tuaj me të vërtetë të interesuar për nënshkrimin e armiqve? Kjo ishte pika e tretë, o vëllezërit e mi!

Pasha Zotin, më vjen keq për ju që ende të numëroj, edhe pse kam shumë shembuj... O bijtë e mi!

Ju tash përjetoni mospajtime të hatashme që do t'ju shkatërrojnë. Unë nuk jam pesimist dhe jam i sigurt se nëse përgatiteni, do të fitoni. Fitoren e kanë vërtetuar etërit tuaj në betejën e Bedrit dhe në kohën e Salahuddinit, i cili e çliroi Jerusalemin dhe i dëboi kryqtarët...

Besoni, o fëmijët e mi, se armë e fitores së tyre ishte vetëm "imani dhe morali". Imani e kompensoi mungesën në përgatitje e numër kurse morali shkaktoi dështimin e armiqve të tyre.

O bijtë e mi! Në luftë fiton morali burror, gjaku, plumbi, baruti dhe pagjumësia në hendeqe e jo ngjyra e kuqërremtë, lavdërimi i fytyrave dhe dhuratave e as pagjumësia në klube, mëkate e kurvëri.

O bijtë e mi! Ju jeni më të mirët e popullit, e përcjellni udhëheqësin më të madhëruar, mbani mesazhin më të lartë, trashëgoni qytetërimin më fisnik, mbron vatanin më të shtrenjtë

dhe i përballoni armikut. Për këtë, ose ta pranoni përgjegjësinë e të shpërbleheni me jetë më fisnike dhe me famë të amshueshme ose "s'ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull që ai e do atë (popull) dhe ata e duan atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë tirani."

Lamtumirë, o bijtë e mi, ju këshillova dhe ua tregova qëllimin tim; do ta mbani në mend atë që ua thash e unë tash i mbështetem Zotit!

Ramazani thotë:

Nëse dëshiron të njohësh madhësitinë dhe kulturën e ndonjë populli, hulumto udhëheqësit, rolin e tyre në të dhe shërbimin e tyre dhe atë me një precizitet të madh ashtu që nuk do të mashtrojë zbukurimi sipërfaqësor.

Nëse dëshiron ta njohësh vlerën e udhëheqësve, bëj një krahasim mes fjalëve dhe veprave të tyre, mes të kaluarës së tyre dhe të tashmes dhe mes lidhjeve të tyre me popullin, e nëse i gjeni më të shpejtë në vepër se në fjalë, të njëjtë si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, stabilë në parimet e tyre prej fillimit deri në mbarim, respektues të popullit dhe interesit të përgjithshëm, atëherë atyre u takon respekti, nderi, dashuria dhe vlerësimi.

Nëse dëshiron të hulumtosh moralin e popullit, pastërtinë, nderin, diturinë, ëndrrën, fisnikërinë dhe besën e tij apo të kundërtën, atëherë shih moralin e udhëheqësve të njohur sepse vetëm kështu do të zbulosh çdo gjë.

Nëse dëshiron ta njohësh sinqeritetin e udhëheqësit, hulumto mendimin e armiqve dhe sjelljen e tyre me të. Nëse e quajnë armik të ndershëm dhe nëse e trajtojnë si armik kokëfortë e të

rrezikshëm, atëherë ai është i cili qëndron me sinqeritet para popullit, jep shpirtin dhe sakrifikon trupin.

Nëse dëshiron të njohësh se cili udhëheqës është më i dobishëm për popullin e vet, shiko ate që e mbron të vërtetën, ofron bashkëpunim, harron egoizmin, shkelë mbi epshet e veta dhe mbi pozitën shtetërore në rastë se e thërret xhihadi për shpëtimin e vendit. Udhëheqësi i tillë e ka arritur kulmin e udhëheqjes, jeta e tij është pasuri për popullin, xhihadi i tij konsiderohet mëshirë për masën kurse humbja e tij që është goditje për vatanin, plotësohet vetëm me ndonjë njeri të ngjashëm me të.

Kështu vlerësohet madhështia e popullit, moralit dhe udhëheqjes së tij. Ky vlerësim është i saktë dhe i vërtetë sepse qysh para katërmbëdhjetë shekujsh e deri më tash nuk ka qenë i gabuar asnjëherë.

Thashë: "Ti e ke parë të kaluarën e të tashmen si dhe e ka parë me sytë e tu famën e Islamit dhe dështimin e tij, pra, çfarë rezultati jep vlerësimi yt i popullit tonë dhe i udhëheqësve tanë të sotëm?"

Mori frymë thellë e tha: "Mjerë për popullin tënd dhe mjerë për udhëheqësit e tij! Do të humbin të dy, udhëheqësi dhe i udhëhequri".

Më pyet për popullin tënd dhe udhëheqësit e tij, e unë të përgjigjem se populli është ashtu siç duan udhëheqësit të jetë, dhe se gjykimi për të mirë ose për të keq varet nga udhëheqësit që veprojnë ashtu siç duan! Udhëtova nëpër botë, në të kaluarën e në të tashmen dhe pashë shumë popuj që u zhvilluan e pastaj u zhdukën, mirëpo nuk pashë gjë më të çuditshme se udhëheqësit tuaj bashkëkohorë. Udhëheqësit e popujve të botës janë syçelë para fatkeqësive, respektues të betimit, kanë mendje të zhvilluar dhe veprime të matura, i analizojnë çështjet me përpikmëri dhe e udhëheqin popullin kah e vërteta e qartë; në rast nevojë të gjithë

bashkohen dhe nëse ndiejnë rrezikun nga armiku tubohen e i përballojnë bashkërisht, sakrifikojnë shpirtin dhe pasurinë për hir të popullit me dëshirë dhe bindje të plotë; lodhen që populli i tyre të jetojë në lumturi, mundohen që vendi të gëzojë kënaqësi dhe vdesin që populli të jetojë.

Udhëheqësit e vendeve tuaja u zhvilluan në mesin e një populli të lodhur nga katastrofat e kohës, të përçarë nga turbullitë e fatit dhe të deformuar nga politika e udhëheqësve. Pastaj, ata e panë me sytë e tyre vazhdimësinë e problemeve, armiqtësinë kundër të drejtave të popujve dhe lojën e intrigave, gjë që mjafton ta nderë zjarrin e xhihadt në zemrat e tyre, ta ngjallë ndjenjën e përgjegjësisë së madhe dhe t'i nxitë për shpëtim e reformë me sinqeritet e iman derisa ta shpëtojnë popullin nga kthetrat e të huajve, ta nxisin mbrojtjen e nderit dhe famës, të ndërtojnë një shoqëri të re që përqëndrohet në zgjuarje, moral e devotshmëri dhe ta sigurojnë pozitën në hapësirën e nënqiellit. Por si vepruan udhëheqësit tuaj?

Pasha Zotin, u tmerrova nga veprat e tyre... Nuk dua të t'i theksoj tash veprat e tyre që do t'i gjykojë historia, por, pash Zotin, a nuk i dehën nervat e popullit dhe a nuk e eliminuan gatishmërinë e tij për luftë? A nuk i përçanë intrigat e armiqtë dhe dëshirat për pushtet? A nuk e larguan popullin prej rrugës së mirësisë, fesë, jetës dhe fuqisë në rrugën e shtrembët e të dështuar, fillimi i së cilës është epshi, mesi mjerim kurse fundi nënçmim e poshtërim?

A nuk ndikoi kënaqësia e komoditetit në vështirësitë e xhihadtit kështu që filluan ta preferojnë luksin dhe mendjelartësinë e rrejshme mbi jetën askete dhe luftimin në rrugë të Zotit? A nuk u përçanë edhe pse shteti jetonte në mjerim kurse populli në vuajtje?

Shiko..., ata luftojnë njëri-tjetrin me armiqtë të ndërsjellë dhe e fyejnë nderin e njëri-tjetrit kurse armiku, i cili qëndron ulur mbi gjokset e tyre dhe ka pushtuar vendin është armatosur me armë, qëndron anash dhe qeshë me ironi!

Mjerë për këtë ndryshim të deformuar dhe për këtë rrugë të keqe!"

Ramazani tha: "Ndoshta të habitë kjo revoltë e imja kundër udhëheqësve tuaj, dhe mund të thuash se qëndrimi im është i përgjithshëm dhe se më mirë do të ishte sikur të mbështetesh në specifikim, mirëpo unë dëshiroj që ti ta dishë plotësisht se populli yt ende ndien varfëri në udhëheqësit e vet dhe se ka nevojë vetëm për një udhëheqës që i plotëson të gjitha kushtet e udhëheqjes dhe qeverisjes!"

Thashë: "Tash, o Ramazan, na trego mendimin tënd në këtë natë të errët!" Ramazani tha:

"Dëgjomë, Zoti të bekoftë! Gjatë shetitjes sime të mbrëmshme nëpër shoqëritë agjëruese, shënoja në ditarin tim, dhe kur, papritmas, pashë një djalosh trupgjatë, të hollë e fytyrëkuq që ishte ulur në një dhomë prej të cilës dilte një dritë e vogël para vitrinave të librave, kurse afër tij, sipas mendimit tim, ishte ulur shoku i tij. U afrova pranë tyre për ta dëgjuar bisedën e tyre.

Djaloshi iu drejtua shokut të vet me një zë të fuqishëm e me entuziazëm të plotë dhe i tha: "Ne jemi popull i njohur me etërit tanë dhe me famë të lartë, pra mëkat është t'i nënshtrohemi Perëndimit dhe vrazhdësisë së tij! Populli ynë udhëhoqi botën dhe mëkat është që të na sundojnë sot ata që kërkonin dje ndihmë prej nesh! Në damarët e popullit tonë ende rrjedh gjaku i krenarisë dhe mëkat është të pushojmë! Popullin tonë e lanë pa gjumë ngjarjet e kohës gjersa u zbardhën bebëzat e syve dhe mëkat është të mos mundemi ta aplikojmë atë që e mësuam! Popullin tonë e udhëheqin udhëheqës fatkeqë dhe mëkat është të mos ua tërheqim vërejtjen! Populli ynë është ende i gjallë dhe i fuqishëm, pra duhet t'i udhëzojmë udhëheqësit ashtu siç mendojmë ne e jo siç mendojnë ata".

Ramazani tha: "Duke i dëgjuar ata, m'u rrëqeth trupi dhe u binda se xhungla është ende e mbushur me luaj dhe se populli që ka një djalosh të tillë me iman, besim e entuziazëm, asnjëherë nuk vdes.

Problemi më i madh është ai i udhëheqësve, pra a mund t'ua përcjellish porosinë dhe thirrjen time?"

Thash: "Si urdhëron!" Thuaju udhëheqësve tuaj: "Pasi që mirësia dhe fuqia ekzistojnë a do të mundeni ta ringjallni me singeritet mirësinë dhe ta nxjerrni fuqinë prej thellësirave për ta ngritur famën e popullit?" Thuaju udhëheqësve tuaj: "Pasi që populli ju ka besuar dhe ju ka ndihmuar, atëherë kjo përçarje e juaj është prerje e dorës së tij (popullit) dhe thikë në zemër. Si e preni dorën që ju ndihmoi dhe si e shponi zemrën që ju don?" Thuaju udhëheqësve tuaj: "Ai që nuk mëson nga përvoja, është i marrë; ai që nuk preket nga ngjarjet, është i dobët; ai që vrapon pas epshit, është vetëvrasës; si mund të prijë apo të udhëheqë ai që është prej tyre?" Ramazani tha: "Kjo ishte biseda ime e sotme me ty, ndoshta herën tjetër do të flas diçka tjetër!"

LAMTUMIRA E RAMAZANIT

Ramazani tha: Dua ta përfundoj bisedën time me disa fjalë të përgjithshme rreth vuajtjeve të mia, këshillave dhe mendimeve që më preokupojnë dhe varet prej teje se a do t'i përcjellish në popull apo jo. Të gjithë popujt pësojnë ndryshime të shumta: fillim e mbarim, fuqi e dobësi, famë e nënshtrim edhe ate nën ndikimin e faktorëve natyrorë. Populli mund ta arrijë kulmin e famës, autoritetin dhe qytetërimin që i përmirëson rregullat e shoqërive dhe siguron lumturinë e tij, mirëpo do të përparojë me sukses të plotë derisa të mos depërtojë në të pasiviteti, ta kaplojë fshehtësia e ta dehë vrapimi pas epsheve dhe kështu fillon të shkatërrohet dhe përjeton vdekjen një kohë të gjatë pas shijimit të jetës së lumtur. Populli mund të jetë i lodhur dhe i dobësuar nga katastrofat që e dërrmojnë jetën mirëpo pas një kohe do t'i çelë sytë në dritë, do ta braktisë fshehtësinë, do të ngrihet sikur luani që lëshohet nga kafazi në liri dhe pas një përpjekje disavjeçare do ta eliminojë dekadencën shumëshekullore, do të fitojë autoritet në mesin e popujve të gjallë dhe do të udhëheqë për t'i realizuar të drejtat, drejtësinë dhe paqen në mesin e popujve të terrorizuar.

Në të dy rastet, duhet të ketë vëmendje të plotë dhe të veprojë me urtësi. Në rastin e fuqisë, duhet të merr shembull prej paraardhësve të famshëm që i shkatërroi koha dhe t'i hulumtojë shkaqet e fuqisë dhe dekadencës së tyre.

Në rastin e dobësisë, duhet t'i hulumtojë shkaqet që i përparuan popujt e mëparshëm dhe t'i aplikojë. Nuk dua ta teproj me shembuj rreth autenticitetit të kësaj teorie sepse në historinë e popullit tënd musliman kaluan periudha të ndryshme që të bindin plotësisht në te. Cili i mençur mohon se faktori më i rëndësishëm që lartësoi famën e muslimanëve të hershëm ishte frika e tyre nga Zoti i Madhëruar, braktisja e kënaqësive afatshkurte të kësaj bote dhe përqëndrimi i përbashkët në lartësimin e fjalës së Zotit dhe

flamurit të Islamit? Kur më vonë e humbën namazin, kur u dhanë pas epsheve dhe u përçanë pas bashkimit që ishte begati e Zotit xh.sh., Zoti i sprovoi me poshtërim, prej të cilit vuajnë edhe sot. Ju tash largoheni nga poshtërimi dhe dëshironi të përparoni dhe nuk mohoj se shpirti i zgjuarjes është riaktivizuar në brendësinë tuaj, mirëpo më pikëllon fakti se nuk shoh syçeltësi në rregullimin e çështjeve tuaja por bredhni të hutuar nëpër rrugët e errësirës me mendime të ndryshme, pra, si do të keni sukses në rilindjen tuaj me këtë gjendje të mjeruar?

Dëshironi ta riktheni famën e etërve tuaj dhe mburrjen e tyre, mirëpo ku jeni ju e ku ishin ata? "Dallimi mes jush është shumë i madh". Ata e vendosën pëlqimin e Zotit xh.sh. mbi dëshirat e tyre dhe adhurimin e Tij mbi epshet e tyre. Ata e kuptuan Islamin si ligj të plotë e të pandarë dhe respektuan çdo imtësi të tij me vullnet të plotë. Ata largoheshin nga mëkatet ashtu siç largoheni ju sot nga epidemitë e sëmurjeve. Transmetohet se gjatë një beteje të vështirë filluan të rikujtojnë ndonjë mëkat eventual që ua vështirësonte fitoren dhe u ra ndërmend se nuk e kishin aplikuar sunnetin e misvakit dhe kështu i pastruan dhëmbët me misvak, derisa armiku mendoi se i mprehin dhëmbët për t'i përbirë të gjallë dhe kështu ai (armiku) humbi.

Ata e konsideronin jetën vegël për përfitimin e gradave të larta në botën tjetër dhe me dëshirë të flaktë pritnin flijimin e jetës, si dhe e lutnin Zotin, ditë dhe natë, që të mos i kthejë në vendlindje, as te familja e as tek fëmijët e tyre.

Ata e rregulluan shoqërinë nga frika prej Zotit xh.sh. kurse udhëheqësi interesohet për popullin e vet më shumë se nëna për fëmijën e saj; nuk pritonte ta udhëheqë botën kah e vërteta pa i marrë parasyshë pasojat negative kurse i pasuri e shpërndante pasurinë e vet me plotë dëshirë edhe ate vetëm për hir të Zotit xh.sh. Tregtari ishte i sinqertë e besnik në shitblerje kurse femra

kishte zemër të pastër e të sinqertë dhe i zbatonte rregullat e Zotit të Madhëruar.

Etërit tuaj ishin ata të cilët fituan kundër një mijë idhujtarëve edhe pse ishin vetëm treqind veta; ata ishin heronjtë e Kadisijes, Jermukut, Hittinit dhe luftërave tjera historike, kurse udhëheqësit tuaj të sotëm janë tiranë, dijetarët flejnë, të pasurit janë strofulluar, rinia është çorientuar, tregtarët janë bërë gënjeshtarë e mashtrues, kurse gratë stolisen dhe largohen nga udhëzimi i Zotit xh.sh. Ju sot jeni zhytur në mendjemadhësi, në epshe e në gjumë aq shumë saqë u janë errësuar mendjet, zemrat dhe sytë sepse për qëllim kryesor keni botën, luksin, pasurinë dhe pozitën e rrejshme dhe luftoni për to.

Nuk është çudi që bota u përkulej etërve tuaj kurse ju i përkuleni botës.

Nuk është për t'u habitur se Zoti xh.sh. atyre ua jepte atë që e dëshironin kurse juve ua merr dhe jetoni nën dirigjimin e epsheve.

Nuk është çudi se fjala e tyre mbizotëronte në botë kurse juve ju udhëzojnë njerëz të çoroditur. "A është i njëjtë ai që iu bind Allahut dhe kërkoi kënaqësinë e Tij, si ai që tërhoqi kundër vetes hidhërim të madh nga Allahu?" (Ali Imran: 162)

"A është më i udhëzuar ai që ecë i përmbysur me fytyrë për tokë, apo ai që ecë i bindur rrugës së drejtë?" (El-Mulk, 22)

"A mos do t'i barazojmë ata që besuan dhe bënë vepra të mira me ata që bënë shkatërime në tokë, apo do t'i konsiderojmë njësoj si të ruajturit prej të këqijave, ashtu edhe ata që janë mëkatarë?" (Sad, 28)

Ky është dallimi mes jush dhe etërve tuaj dhe ky është shkaku kryesor i disfatës suaj. Pasi që sot vendosa të shkoj, të lutem përcjelli këto fjalë vijuese në mesin e vëllezërve muslimanë:

O muslimanë!

Si pranon populli që ka fe, mendje e inteligjencë t'u nënshtrohet popujve që kanë karakter të dobët, zemër mizore, moral të shëmtuar, tradita dhe shije të palakmueshme, si dhe i shoqërojnë Zotit xh.sh. shok dhe e refuzojnë fenë e Tij?

O muslimanë!

Nëse armiqtë tuaj idhujtarë dominojnë në botë, atëherë a nuk është më mirë që ju të dominoni me besim në Të? Nëse ata sundojnë me dëfrime e amoral, a nuk është më mirë ju të sundoni me devotshmëri e pastërti?

O muslimanë!

Jeta është pasuri dhe u takon vetëm falënderuesve, kurse falënderimi nënkupton përballimin e vështirësive të kohës, ngritjen kundër intrigave të armikut dhe qytetërimin me fenë e Zotit xh.sh. Me dhembje në zemër dhe me lotë në sy ju përshëndes, o muslimanë!

Lamtumirë, o muslimanë!

Unë sot do të takohem me Zotin tim dhe do t'ia parashtroj zhvlerësimin e monoteizmit (tevhidit), famën e idhujtarisë, keqtrajtimin e udhëzimit, vrazhdësinë e fatit dhe vdekjen e ndërgjegjes: "Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim, ia parashtroj Allahut." (Jusuf, 86)

Ramazani tha: "Zoti të lashtë!"

Kështu, ai mori rrugën kurse mua m'u tha fryma nga pikëllimi i ndarjes.

FILOZOFIA E BAJRAMIT

Mbarë bota islame pasnesër me hare feston Bajramin, jepen sadakatë, vizitohen anëtarët e familjes dhe shokët, njerëzit veshin rroba të bukura e të reja...

Ç'është qëllimi shoqëror dhe njerëzor i Bajramit dhe si duhet të jetë edukata apo morali jonë gjatë kohës së tij?

Qëllimi shoqëror i Bajramit është të mbjellë harenë në zemra, gëzimin në shpirta, qetësinë e trupave, përforcimin e dashurisë shoqërore, mëshirën mes të afërmeve dhe bashkëpunimin e ndërsjellë njerëzor.

Në këtë festë afrohen zemrat, bashkohen me lidhje miqësore, harrohen urrejtjet, takohen pas ndarjes, pajtohen pas mosmarrëveshjeve, shtrijnë dorën e pajtimit, gjegjësisht ripërtërihen lidhjet shoqërore e njerëzore me dashuri, sinqeritet e vëllazërim.

Qëllimi shoqëror i festës është rikujtimi i ndërtuesve të shoqërisë për të dobëtut dhe të paaftit derisa çdo shtëpi dhe çdo familje të mbushet me gëzim e hare. Këtë qëllim të lartë shoqëror e simbolizon urdhërimi i "Sadakatul-Fitrit" në festën e Bajramit të Vitrit (të Madh) dhe i prerjes së kurbanëve në festën e Bajramit të Kurbanëve (të Vogël).

Dhënia e vitrave para festës paraqet shtrimin e dorës së mirësisë.

Para se të lindë dielli ditën e Bajramit, buzëqeshja i kaplon fytyrat e të gjithë njerëzve dhe hareja dominon në zemrat e fëmijëve të shoqërisë.

Qëllimi njerëzor i festës është shoqërimi i një numri të madh njerëzish në gëzim e hare, në një kohë të caktuar si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Kështu njerëzit ndjejnë lumturi të përbashkët,

kurse fëmijët e një populli, pa marrë parasysh shtëpitë e shpërndara, bashkohen në të mirë e në të keqe. Në festë forcohen lidhjet ideologjike e shpirtërore që i caktoi feja për njerëzit, pa marrë parasysh llojllojshmërinë e gjuhëve dhe kombeve...

Këto ishin disa nocione shoqërore e njerëzore të festës. Pastaj festat i prezentojnë këto nocione në çdo shoqëri dhe ai i cili dëshiron ta njeh moralin e një populli, le t'i përcjellë festat e tyre të cilat paraqesin realitetin e ndjenjave dhe traditave të tyre.

Shoqëri e lumtur konsiderohet ajo që e lartëson deri në kulm moralin dhe ndjenjën njerëzore gjatë kohës së festës, sepse në këtë kohë ajo tregon bashkimin, kooperimin dhe mëshirën e ndërsjellë të saj, derisa çdo zemër mbushet me dashuri, mirësi e kënaqësi dhe çdokush ia tregon vëllait të vet hallet e veta në rast të katastrofave ose ngjarjeve tragjike, qoftë edhe në vende tjera.

Si veprojmë ne me këto nocione shoqërore e njerëzore gjatë festave tona bashkëkohore? Si është realiteti i moralit tonë shoqëror?

S'ka dyshim se festat tona atribuohen me disa nocione kooperuese shoqërore të sadakave dhe mirëbërjeve ndaj shtëpive të varfëra dhe familjeve të mjera por jo aq sa duhet, gjeqjesisht jo aq sa harxhojmë në luks, dëfrim, udhëtime e gosti. Pra, mjafton të japim më pak sesa kot të bëjmë harxhime të mëdha dhe rrallëherë japim pa na rikujtuar ndokush!

Njerëzit, të cilët jetojnë të mbyllur në shtëpitë e tyre dhe nuk kërkojnë lëmoshë për shkak të mbrojtjes së nderit dhe dinjitetit, përfetojnë mjerim gjatë ditëve të festës. Ne ndoshta i harrojmë mirëpo njerëz të tillë kemi afër nesh, qoftë me lidhje familjare, shoqërore apo fqinjësore; kjo harresë nuk bën pjesë në shoqërinë e lumtur.

Kur populli ynë shijonte lumturinë e festës fqiu mendonte për fqin e vet para se të mendonte për veten dhe i preferonte nevojat e fëmijëve të shokut mbi nevojat e fëmijëve të vet.

El-Vakidiu, dijetar i njohur i shekullit të dytë hixhrij, rrëfen një ngjarje kështu: "Kisha dy shokë aq të ngushtë sa e ndienim veten si një, kurse njëri prej tyre ishte hashimij. Kur përjetova një vështirësi gjatë një feste të Bajramit, shoqja më tha: 'Përjetojmë mjerim e vështirësi, dhe kur i shoh fëmijët me rroba të vjetra, më tronditet zemra, pra mendo se si t'ia bëjmë'."

El-Vakidiu vazhdoi më tutje e tha: "I shkrova shokut tim hashimij një letër, dhe i kërkova ndihmë, kurse ai më dërgoi një qese me 1000 dirhemë. Sa i mora në dorë, kur ja, pranova një letër nga shoku tjetër, në të cilën ankohet ashtu siç iu ankova shokut tim hashimij, dhe ia dërgova qesen e posapranuar. Për këtë e lajmërova shoqen time e cila më lavdëroi e s'më qortoi. Derisa isha në atë gjendje, papritmas më erdhi shoku hashimij, më solli një qese sikur ajo e para dhe më tha: 'Me trego se ç'bëre me qesen e parë që ta dërgova ty?' Pasi që ia rrëfeva ngjarjen, më tha: 'Kur më kërkove para i kisha vetëm ato që t'i dërgova, pastaj kërkova prej shokut tim të tretë të më ndihmojë, e ai ma dërgoi qesen që ta dërgova ty...'"

El-Vakidiu pastaj thotë: "Kështu, i ndamë 1000 dirhemët mes nesh, ashtu që secili prej nesh mori nga 300 kurse e shoqja 100 dirhemë. Pasi që këtë lajm e kishte dëgjuar Me'muni më thirri dhe më pyeti e unë ia vërtetova lajmin. Pastaj ai urdhëroi të na dhurojnë 7000 dirhemë, gjegjësisht për secilin nga 2000 kurse për shoqen 1000 dirhemë".

Ky është fenomen i singertë i lartësisë së moralit shoqëror në çdo popull.

S'ka dyshim se ne nuk i rikujtojmë vëllezërit tanë të tjerë gjatë festës, p.sh. në shtetin tonë në Siri, ka vende që i ka kapluar

thatësia, konkretisht në Horan, dhe për këtë shkak banorët e këtij qyteti u shpërndanë nëpër vende tjera duke kërkuar kushte më të volitshme për jetë. A e kujtuam ne katastrofën e tyre? A i menduam vuajtjet e tyre nga skamja, etja e uria?

Në mbarë vendin tonë arab zhvillohen revolucione e ndizen zjarre kundër kolonializmit tiran derisa u rrënuan shtëpitë dhe u ndanë familjet; armiku i shkatërron me të madhe popujt tanë kurse mbrojtësit e popullit braktisën jetën e qetë dhe begatinë dhe iu vërsulën me pak armë armikut të armatosur deri në dhëmbë, bile ende luftojnë për çlirimin e vatanit të okupuar e të jetojnë si popujt tjerë, gjegjësisht të jetojnë me nder e singëritet. Çka u ofruam ne? Çka mendojmë të ndërmarrim për ta në kohën e festave?

Mund të paramendoj se kremtet tona të pasnesërme do të jenë ashtu siç ishin në festat e kaluara, ashtu sikur bota jonë nuk vuan nga katastrofat e tragjeditë, sikur populli ynë në disa vende nuk vuan nga pikëllimi i dëshmorëve të vdekur!

Unë nuk kërkoj prej njerëzve t'i veshin mburojat e hekurta e as të derdhin lot për dëshmorët e lirisë dhe të vërtetës, as të izolohen në shtëpitë e tyre ashtu siç izolohet njeriu i goditur me fatkeqësi të madhe si vdekja e të afërmit, të dashurës etj., e as të largohen nga ngrënia e pija ashtu siç largohen agjëruesit. Unë s'kërkoj gjëra të tilla, por kërkoj që populli ynë ta tregojë veten të vetëdijshëm gjatë festave tona përkujtimore e fetare dhe ta ndiej atë që e ndjejnë njerëzit tanë të tjerë; dëshiroj që ta pakësojmë dëfrimin dhe teprimin e t'ia ofrojmë popullit tonë nevojat që i ndien gjatë luftës së hidhur e shkatërruese.

Dua që të ndjejmë lidhje të fuqishme vëllazërore gjatë ditëve të festës ashtu që katastrofat, që i përjetojnë vëllezërit tanë, të na nxisin në dhënie e sakrifikim.

Dua që ta kufizojmë qeshjen tonë e të vërehet pikëllimi i singërtë në fytyrat tona për shkak të interesimit tonë të madh për

çështjet tona dhe ngjarjet e katastrofat që ndodhin në vatanin tonë të gjerë.

Dua të mos e harrojmë Palestinën, vatanin tonë të plagosur që e përjeton terrorin e sulmuesve të egër; të mos e harrojmë popullin tonë të shpërndarë nën qiellin e pastër duke kërkuar prej popujve tjerë vendstrehim, kafshatë buke, ujë dhe shërim; të mos e harrojmë Marokun tonë i cili në kohën e festave i varrosë dëshmorët, i shëron të plagosurit, u ndihmon fatkeqëve dhe përgatitet kundër tiranëve okupues; të mos e harrojmë rrezikun që i kërcënohet mbarë popullit tonë nga intrigat e kolonializmit, eliminimi i lirisë, maltretimi i të lirëve, plaçkitja e pasurive që shkojnë në arkat e kolonialistëve për ta rritur kënaqësinë, luksin dhe fuqinë e tyre në llogari të popullit tonë të varfër e të përvuajtur!

O vëlla fisnik!

S'ka dyshim se ti përgatitesh për festën e Bajramit, qofsh babë, nënë, burrë, grua, djalë apo vajzë si dhe s'ka dyshim se ofron çdo gjë që është e nevojshme për festë, si veshja, ushqimi dhe dëfrimi, por shto edhe një përgatitje tjetër të çmueshme për Zotin xh.sh. dhe të vlefshme për vëllezërit, gjegjësisht përgatitjen për mënjanimin e barrës dhe vështirësive nga të mjerët dhe të varfërit e mjedisit tënd!..

Kërko fqin tënd, të afërmin apo anëtarin tjetër të shoqërisë dhe pyete për nevojat e tij, ndihmoi që të depërtojë gëzimi në zemrat e fëmijëve dhe gruas së tij, e nëse s'mundesh një gjë të tillë, atëherë ndihmoi me fjalë të mira, buzëqeshje të këndshme, dëshira të sinqerta nga zemra yte islame dhe përkujtoi vëllezërit që vuajnë në botë!

Në mëngjesin e festës kur t'ua urosh anëtarëve të familjes festën dhe kur të tuboheni rreth ushqimit të këndshëm e pijeve të freskëta, përkujtoi të vobektit që nuk e kanë në atë mëngjes

buzëqeshjen e të jatit të tyre, të vejat që nuk e përjetojnë dashurinë e burrave të tyre dhe refugjatët që i deportoi kolonializmi mizor, sepse këta njerëz e presin festën me lot në sy, janë të preokupuar me zjarr dhe nuk e shijojnë qetësinë, sigurimin dhe paqen.

Pos këtyre, rikujto edhe veten tënde, sepse kur pikëllohesh për plagët e vëllezërve tuaj, pikëllohesh edhe për plagën tënde dhe kur i plotëson nevojat e fqinjve tuaj, i plotëson edhe nevojat tua personale. Zoti i Madhëruar thotë:

"Çkado që të jepni nga pasuria, e keni për veten tuaj". (Bekare: 272) "Kush bën mirë, ai e ka për vete". (Fussilet: 46)

Pasha shpirtin tim, s'ka më të madhëruar e më të lartësuar se Muhammedi a.s., i cili kur ua mëson njerëzve dashurinë, mirësinë dhe vëllazërimin, thotë:

"Ai që e shpëton vëllain e vet nga ndonjë vështirësi e kësaj bote, Zoti e shpëton atë nga një vështirësi në botën tjetër".

"Zoti i ndihmon robët (njeriut), gjersa ai i ndihmon vëllait të vet". (Muslimi).

"Kush nuk interesohet për çështjet e muslimanëve, s'është prej tyre (s'është musliman)." (Hakimi).

"Shembulli i dashurisë dhe i mëshirës së ndërsjellë tek besimtarët i ngjanë trupit, gje gjësisht nëse ankohet një organ, ankohen edhe organet tjera". (Muslimi dhe Ahmedi).

- O Zot, na bën prej atyre, të cilët të falënderohen për begatitë Tua, u ndihmojnë vëllezërve dhe i përgjigjen thirrjes Sate në çdo rast e në çdo kohë!

O Zot, unë jam këtu, para Teje! O Zot, deklaroj se s'ke shok!

O Zot, deklaroj se falënderimi, begatia dhe sundimi të takojnë vetëm Ty! O Zot, deklaroj se s'ke shok!

PËRKUJTIMI I "ISRASË DHE MI'RAXHIT" NË HISTORINË TONË

Një ndër përkujtimet më madhështore në historinë islame dhe më të gëzuara për muslimanët është përkujtimi i natës së sotme, gjegjësisht natës së "Israsë dhe Mi'raxhit". Gjatë kësaj nate tubohen muslimanët e tërë botës nëpër shtëpitë e Zotit (xhami), i përsërisin detajet e kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme që i ka ndodhur të Dërguarit të Zotit para 14 shekujsh, nxjerrin këshilla e shembuj, e paramendojnë kujdesin e Zotit xh.sh. ndaj të Dërguarit të Tij fisnik dhe i betohen Zotit se do të largohen nga çdo amoralitet i urrejtur, do të atribuohen me sjelle të lavdëruara dhe ripërtërijnë betimin e tyre para Zotit xh.sh., singëritetin ndaj të Dërguarit të Tij dhe qëndrimin në fenë e Tij.

Nuk dëshirojmë këtu ta argumentojmë Isranë në aspektin historik apo logjik sepse njerëzit janë dy llojesh, lloji që nuk beson në Zot e as në metafizikë kështu që s'ka kurrfarë dobie të flitet me ta për Isranë dhe Mi'raxhin para se të binden në ekzistimin e Zotit dhe në mesazhet e të dërguarve të Tij, dhe lloji që beson në Zotin e Madhëruar dhe mesazhet e Tij. Edhe nëse nuk janë muslimanë, gjejmë se librat e tyre fetarë janë të mbushur me mrekulli të profetëve kështu që nuk mund ta mohojnë këtë fenomen sepse besojnë edhe në anën tjetër që vjen pas intelektit, si p.sh. mrekullitë dhe fenomenet e jashtëzakonshme të natyrës. Nëse janë muslimanë, atëherë mjafton se kjo ngjarje është shënuar qartë në Kur'anin Famëlartë:"

"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (Ia bëmë këtë udhëtim) për t'i treguar atij disa nga argumentet Tona." (El-Israë:1).

"Pasha yllin kur ai bie (prej së larti poshtë)! Miku juaj (Muhammedi që ju e njihni) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar (nga e vërteta). Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur'ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet. Atë ia mësoi, ai fuqiforti (Xhibrili), që ka mendje precize dhe që u përqëndrua në formën e vet (reale). Dhe ai (Xhibrili) ishte në horizontin e lartë (nga lindja). Pastaj u lëshua dhe iu afrua. E ishte afër sa dy harqe (dy kute) apo edhe më afër". (En-Nexhm: 1-9).

Mua më intereson që nga kjo që u tha të nxjerrim dobi për realitetin tonë bashkëkohor dhe t'i rikujtojmë ngjarjet që ndodhën gjatë historisë.

Arabët ishin të izoluar nga bota e jashtme. Kur u dërgua Muhammedi a.s. pos disa

lidhjeve të kufizuara, ishin larg ndikimit të tyre në ngjarjet politike e shoqërore, të përçarë brenda Siujdhesës dhe nuk mendonin të bashkohen ndonjëherë me vendet tjera si Egjiptin, Irakun dhe Shamin. Ndërsa prej sekreteve të gjithësisë e njihnin vetëm tokën, rërën, kodrat dhe ujërat.

Hyjnia e perëndisë materializohet me duart e tyre, u drejtoheshin idhujve me lutje e adhurim dhe aty merrnin fund shpresat e tyre. Kështu ishin kur Muhammedi a.s. e shpalli thirrjen e tij që përqëndrohej në besimin në një Zot, Krijues të gjithësisë e jetës, në fshehtësitë dhe sekretet e mrekullueshme të gjithësisë, në konsiderimin e shkencës dhe mendjes si parime të teorive shkencore, shoqërore e politike. Edhe pse mesazhi i Islamit i thirrte në reformimin e gjendjes së tyre fetare e ekonomike, ata ishin të vetëdijshëm se fati ua kishte caktuar misionin më të madh që mund ta ketë ndonjë popull në histori.

Ai ishte mesazhi i pikënisjes, çlirimit, shkencës dhe qytetërimit në bazë të besimit (imanit), intelektit dhe moralit fisnik. Përderisa kurejshitët e mohonin Muhammedin a.s. dhe e luftonin thirrjen e

tij, ngjanë "Israja dhe Miraxhi" në qiell, gjë që shumë i habiti sepse mes Mekkes dhe Bejtul Mukaddesit distanca ishte e gjatë afër një muaj.

Pra si mundi Muhammedi a.s. të shkojë e të vijë? Njeriu, sipas mendimit të tyre, endet nëpër tokë sepse nuk mund të ecë nëpër qiell, pra si mundi të hipë Muhammedi a.s. e të zbret për disa orë?

Ç'është me Mekken e ç'është me Bejtul-Mukaddesin? Ç'është lidhja mes Qabes dhe Xhamisë Aksa? A nuk ishte Qabja faltore e vetme në tokë për ta? Cilat janë lidhjet mes banorëve të Mekkes dhe atyre të Bejtul-Mukaddesit"?

A nuk ishin banorët e Mekkes më fisnikë se banorët tjerë për shkak se e mbronin Qaben? Çfarë nevojë kishin për popujt tjerë dhe çfarë lidhjesh kishin me ta?

Mendimi i tyre ishte i tkurrur, materialist, idhujtar e injorant. Ata s'mundën ta kuptojnë atëherë qëllimin, të përfitojnë e t'i zbulojnë fshehtësitë e ardhmërisë nëpërmjet asaj ngjarjeje.

Muhammedi a.s. e dinte se populli i tij do ta përgënjejë e do të tallet me të kur t'ia rrëfejë

udhëtimin e tij të jashtëzakonshëm, por këtë nuk e merrte parasysh përderisa mesazhi ishte kah realizimi i qëllimit të vet dhe përderisa tallësit dhe përgënjeshtarët do ta pranonin atë ngjarje pas një kohe, qoftë edhe pas vdekjes së Pejgamberit besnik.

Muhammedit a.s. i besuan besimtarët e vërtetë kurse të tjerët e përgënjeshtroan dhe u larguan... Ata të cilët e përgënjeshtroan dhe u tallën me rrëfimin e tij, pas disa vjetëve e çliruan Bejtul-Mukaddesin e prej aty depërtuan në Lindje, Perëndim, Jug e Veri dhe i bashkuan Shamin, Egjiptin dhe Irakun në një perandori, që prej aty t'i vazhdojnë çlirimet në botë.

Këto ishin informatat burimore rreth ngjarjes së Israsë dhe komentimi i parë realist e politik i qëllimit të thellë e të gjerë të Israsë!

Pas një kohe të shkurtë, ushtritë e kryqëzatave perëndimore trokitën në dyert e Bejtul-Mukaddesit, u bënë gjakderdhje të mëdha nëpër lumenj, rrugë dhe në Mesxhidul-Aksa, e cila u shndërrua në kryeqendër të tyre fetare afër 100 vjet.

Përsëri pas një kohe, Salahuddin Ejubit troket në dyert e Bejtul-Mukaddesit dhe e çliron

pa gjak, pa dhunë dhe pa prishje të betimit. Kështu, Bejtul-Mukaddesi dhe Palestina bien nën pushtetin islam kurse faltoret dhe kishat i konsiderojnë amanet dhe i mbrojnë derisa hyjnë ushtritë aleate në Luftën e Parë Botërore. Komandanti anglez Lanby pas hyrjes thotë:

- "Tash përfunduan luftërat kryqtare (kryqëzatat)".

Ai thotë ashtu për shkak se mendon se e kanë grabitur njëherë e përgjithmonë prej arabëve e muslimanëve. Anglezët dalin prej Palestine por e lënë aty Izraelin në zemër të territorit arab që të dëmtojë, maltretojë e sulmojë... Ja, ende jemi në konflikt të vazhdueshëm e të idhët me Izraelin kurse rrëfimi i Mesxhidi Aksasë dhe i Bejtul-Mukaddesit (vendet e Israsë dhe Miraxhit) ende vazhdon... A e kuptuam fshehtësinë e ngjarjes së Israsë?

A e kuptuam tash qëllimin madhështor të kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme? Sa shumë

përgëzime e paralajmërime ka për ne?

Ngjarja e Israsë ka lidhje të posaçme me Bejtul-Mukaddesin dhe lidhje të përgjithshme me Shamin si dhe me Siujdhesën e Arabisë para se të shndërrohej Shami në territor arab e islam.

Muhammedi a.s. u afrua gjatë Miraxhit me kufijtë shpirtërorë para se t'u afrohej kufijve tokësore afro dhjetë vjet. I Dërguari i Zotit me këtë ngjarje na obligoi neve me një përgjegjësi të madhe, gjegjësisht ta ruajmë këtë pjesë të tokës si pjesë të pandashme të vatanit tonë të madh, të mos u lejojmë sulmuesve shkatërrues që të grabitin qoftë edhe një pëllëmbë derisa të jemi të gjallë, ta mbrojmë dhe ta konsiderojmë mbrojtjen e tij si obligim feje e besimi për secilin që beson në Zot e në botën tjetër.

Ne e festojmë këtë ditë kurse konflikti me Izraelin dhe shtetet kolonialiste është në kulmim e sipër.

Izraeli në vitin 1948 i okupoj vendet më të pjellshme, më të bukura dhe më të pasura të Palestinës, deportoi miliona pleq, gra, fëmijë, djem e vajza, e okupoj Gazën dhe Sherem Shejhin, vrau mijëra banorë të Palestinës, burgosi me mijëra njerëz bile edhe refuzon sot të del, edhe atë duke i përballuar botës mbarë... Izraeli nuk do të vepronte kështu sikur të mos qëndronin pas tij Franca dhe Anglia që janë më të fuqishme, më të pasura dhe më autoritative se Izraeli.

Izraeli me këtë qëndrim e zbuloi fytyrën e vërtetë dhe qëllimet armiqësore ndaj pjesës tjetër të Palestinës, Egjiptit, Jordanisë, Sirisë... Kjo atmosferë e zyrtë me Izraelin na rikujton luftën dhe tmerrret e saj si dhe obligimin e arabëve dhe muslimanëve ndaj këtyre vendeve të shenjta, nga të cilat rrjedhin kujtimet islame derisa t'i bashkojnë me vatanin e tyre të gjerë.

Sikur të ishin këto kujtime të lidhura me ndonjë popull tjetër, që është në konflikt me armiqtë, tiranët, kolonialistët dhe dëmtuesit, do të kishim shumë dobi prej tyre në përf forcimin e fuqisë shpirtërore e materiale si dhe të ndjenjave mbrojtëse.

Pse s'e bëjmë këtë tash? Pse nuk i shfrytëzojmë këto kujtime për zgjidhjen e çështjes së botës islame, gjegjësisht çështjen e tokës

sonë të dashur? Pse nuk i shfrytëzojmë në nxitjen e emocioneve fetare e kombëtare të popullit tonë islam?!...

Përkujtimi i udhëtimit deri në Bejtul-Mukaddes të Palestinës e jo në ndonjë vend tjetër të tokës dhe deri në Xhaminë Aksa që është afër kishës krishtere më të vjetër në botë dhe afër Bejt Lahëm, vendlindjes së Isaut a.s. dhe epiqendrës së krishterëve në botë... na nxitë që së bashku ta çlirojmë këtë pjesë të tokës.

Obligohemi që në këtë ditë ta vizitojmë Bejtul-Mukaddesin historik e të nisemi në drejtim të kufijve që t'i shohim armiqtë dhe armiqtësinë e tyre; në këtë kohë duhet të organizohen festivale në Bejtul-Mukaddes për përforcimin e bindjes së banorëve që janë nën okupimin armiqësor; kjo ditë duhet të konsiderohet festë kombëtare në çdo vend arab e islam për të biseduar rreth historisë dhe ngjarjeve historike të Palestinës.

Pasiqë jemi në konflikt me kolonializmin e fuqishëm, pasiqë fuqitë destruktive orvaten ta grabisin lirinë tonë dhe pasiqë cionizmi botëror e nxitë Perëndimin me gënjeshtër e mashtrime kundër nesh, atëherë pse nuk i përgatisim të gjitha fuqitë e arabëve dhe të muslimanëve për një betejë të tillë. Pse nuk e konsiderojmë këtë përkujtim si përtëritje e bindjes sonë dhe përkujtuese e obligimeve të rënda e sakrificimeve të shtrenjta? Mjetet arabe të informacionit të Kajros, Damaskut dhe Ammanit e transmetuan manifestimin përkujtimor të Israsë në mbarë botën, gjë që tregon se kemi filluar të përfitojmë dobi prej saj dhe ta çmojmë ashtu siç i takon.

A mund të kërkojmë interesim më të madh, e të shohim se manifestimi përkujtimor në vitin e ardhshëm do ta trondisë botën me fjalimet, kremtimet dhe vendimin tonë për kthimin e vatanit të grabitur?

O arabë e muslimanë!

- Dita e njëzet e shtatë e muajit Rexhep në kohën e Muhammedit a.s. ishte dita e hapjes shpirtërore të Bejtul-Mukaddesit.

- Dita e njëzet e shtatë e muajit Rexhep në kohën e Salahuddin Ejjubit ishte dita e çlirimit

ushtarak të Bejtul-Mukaddesit dhe e kthimit prej duarve të okupatorëve.

Përkujtone gjithmonë këtë ditë dhe shndërrone në pikënisje për çlirimin e pjesës së okupuar të Palestinës së shtrenjtë, për çlirimin e pjesëve të okupuara të vatanit arab dhe për çlirimin e botës islame nga gjurmët e kolonializmit, shfrytëzimit dhe armiqësisë.

"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloj në një pjesë të natës prej Mesxhidi-Haramit (Qabes) gjer në Mesxhidi-Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'i treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhammedit), pamësi (i punëve të Muhammedit)".

(El-Israë:1)

NATA E MESIT TË MUAJIT "SHA'BAN"

Kjo është nata e mesme e muajit Sha'ban, në të cilën muslimanët zakonisht aplikojnë lloje të ndryshme adhurimi, si namazi, lutja, pagjumësia, gjegjësisht recitojnë një "dua" të përbashkët në të gjitha xhamitë e shtëpitë.

Ende më kujtohet se si prindi im na tubonte pas namazit të akshamit në një rreth dhe lexonim Kur'an dhe lutnim Zotin xh.sh. me këtë "dua" të njohur pa kuptuar gjë pos përsëritjes mekanike. Edhe pse nuk e kuptonim, përsëri ndjenim modesti, përluje, kënaqësi nga tubimi familjar, lidhje familjare të pastër e të singertë dhe adhurim ashtu siç e kuptonim ne të vegjlit, edhe pse nuk kuptonim fare.

Para se të flas rreth vlerës së kësaj nate dhe urtësisë së saj, ndiej përgjegjësi para Zotit xh.sh. që të them diçka për rregullën e sheriatit për namazin dhe lutjen e përbashkët të njerëzve.

Nuk kemi argumente se Muhammedi a.s. i ka tubuar njerëzit në xhami në këtë natë për lutje e adhurim. Gjithashtu edhe shokët e tij s'kanë aplikuar një veprim të tillë, mirëpo kemi hadithe që e çmojnë adhurimin gjatë kësaj nate dhe agjërimin e ditës. Transmetohet nga Ibn Maxhe se Muhammedi a.s. ka thënë: "Kur të vjen nata e mesme e muajit Sha'ban, adhuron natën dhe agjëroni ditën". Gjithashtu edhe Bejhekiu transmeton nga Aisheja r.a. se Muhammedi a.s. ka thënë: "Kjo është nata e mesme e muajit Sha'ban, Zoti i vështrohet robët e vet gjatë saj, i falë ata që kërkojnë falje, i mëshiron ata që kërkojnë mëshirë dhe i pengon ziliqarët". Në këtë kontekst kemi shumë hadithe që nuk e kanë shkallën e duhur të autenticitetit, mirëpo theksohen në pjesën e vlerës së veprave sepse juristët muslimanë e pranojnë argumentimin me hadithe të dobëta që kanë të bëjnë me vlerën dhe çmimin e veprave.

Lutja e njohur që recitohet nëpër xhami e shtëpia nuk rrjedh nga Muhammedi a.s. as nga shokët e tij e as nga selefët pasardhës si dhe nuk dihet se kush e ka formuluar pos disa pjesëve të transmetuara nga disa njerëz të devotshëm, bile aty ka disa fjalë që nuk i takojnë Zotit të Madhëruar, p.sh. çështja e "shlyerjes". Ajeti, i cili theksohet në këtë lutje: "Allahu shlyen (nga ajo evidencë) ç'ka të dojë, e edhe forcon (çka të dojë)" (Er-Rra'd), nuk kuptohet ashtu siç ceket në lutje e as ashtu siç e kupton masa e gjerë e muslimanëve.

Vlera e kësaj nate është cekur në disa hadithe ashtu që preferohet për muslimanin t'i drejtohet Zotit xh.sh. me lutje e adhurim ashtu siç preferohet dita e saj me agjërim. Lutja më e mirë në këtë natë është ajo që ceket në Kur'an e sunnet sepse në të dy burimet ka lutje të preferuara, me të cilat (muslimani) i drejtohet Zotit në raste të tilla.

Rëndësia e vlerësimit të kësaj nate qëndron aty se Zoti i Madhëruar cakton edukim të kohëpaskohshëm për pastrimin që i ngjanë kohës "pushim-pune", gjegjësisht pushim nga punët e jetës së përditshme që e lodhin trupin dhe shpirtin dhe nga mëkatet si dhe punë për pastrimin e shpirtit, ripërtërirjen e imanit (besimit) dhe përf forcimin e tij.

Njerëzit të cilët janë zhytur në epshe e kënaqësi dhe të cilët i kanë braktisur rregullat e parimet e Zotit xh.sh. kanë nevojë të madhe për përtërirjen e lidhjes së tyre shpirtërore me Zotin dhe moralin e Tij.

Në këtë natë, muslimani përkujton ardhjen e Muajit Ramazan, që është muaj i devotshmërisë, mirëbërjes, adhurimit, përlules fetare, bujarisë dhe i mirësisë. Muslimani e agjëron këtë ditë si parapërgatitje për agjërimin e Ramazanit, lutet natën për t'u përgatitur për netët e Ramazanit dhe kërkon falje për ta pritur

Ramazanin me shpirt të pastër e zemër të qetë, gjegjësisht përgatitet për shpërblimet e Tij dhe për takimin me Të.

Sipas mendimit tim, këto ishin disa fshehtësi të festave të tilla fetare, në të cilat preferohen lutjet, namazi dhe adhurimi për pastrimin e shpirtit, plotësimin e edukatës, ringjalljen e vlerës së lartë shpirtërore dhe pastrimin e zemrës.

Ne kemi nevojë të madhe për netë të tilla për shkak se jemi zhytur në mëkate, zemrat janë bërë të pamëshirshme, duart kanë pranuar koprracinë, sytë janë verbuar dhe jemi larguar nga rruga e Zotit dhe e Pejgamberit të Tij!

Ne kemi nevojë të madhe për netë të tilla për shkak se na kanë kapluar fatkeqësitë, janë ngritur armiqtë kundër nesh, sundojnë arrogantët në tokën tonë dhe janë përforcuar mëkatarët...!

Ne kemi nevojë të madhe për netë të tilla vetëm e vetëm që t'i mbështetemi Zotit, t'i kthehemi të vërtetës, t'i pastrojmë shpirtrat dhe zemrat tona dhe t'i shmangemi asaj që na largoi nga Zoti xh.sh., na e humbi famën dhe na mënjanoi nga bota e feja!

O besimtarë e bij të këtij Ummeti fisnik!

Në kohët e vështira popujt, të cilët duan të shpëtojnë, bëhen të sinqertë dhe bashkohen. Ne sot përjetojmë vështirësi të mëdha, armiku është në kufijtë tanë, gjegjësisht në zemër të vatanit tonë dhe pret çastin e volitshëm për sulm e krim!

Ju e dini se armiku pas fitores së tij do t'i shkatërrojë shtëpitë, do t'i përçajë njerëzit dhe do t'i ndajë familjet, kurse ne mund të korrim fitore kundër tij vetëm me fuqi.

Fuqia në Islam është dylojesh: fuqia e hekurit dhe e zjarrit si dhe fuqia e armatimit dhe përgatitjes. Kjo fuqi në Kur'an theksohet kështu:

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë) e Allahu i di ata." (El-Enfal:60).

Muhammedi a.s. thotë: "Kush lufton, le të luftojë ashtu siç është i luftuar".

Ne e humbëm fuqinë dhe u shndërruam në popull më të dobët edhe pse duhej të ishim më të fuqishmit në tokë!

Fuqia e dytë është fuqia e shpirtit, moralit, burrërisë, drejtësisë, adhurimit, devotshmërisë, lidhjes me Zotin dhe e mburrjes me fuqinë e Tij...

Kjo fuqi, që sot njihet si fuqi shpirtërore dhe morale e ushtrisë dhe e popujve dhe si nevojë elementare për popujt sulmues e ushtrinë sulmuese, ka ndikuar në ngadhënjimet që i realizoi populli ynë në historinë e artë. Ju e dini se populli ynë kur doli nga Siujdhesa s'kishte ashtu siç kishin popujt tjerë, si persianët e romakët, e as njerëz e luftëtarë, mirëpo, përkundër kësaj, korri fitore historike, la gjurmë të përhershme në tokë dhe u zgjerua në Lindje e Perëndim me një shpejtësi që i habitë edhe historianët. Këtu s'ka kurrfarë fshehtësie e as mrekulli, sepse fuqia e shpirtit dhe e besimit i solli në rrugën e fitores me një shpejtësi që i ngjan vetëtimës.

A s'keni dëgjuar për Kadisijen dhe për qëndrimin e delegacionit islam me Rustemin para filimit të betejës? Rustemi grumbulloi tërë pasurinë, armët, arin dhe mëndafshin, tuboi rreth vetes robërit e armatosur deri në dhëmbë, komandantët që kishin shpata prej arit dhe ministrat e stolisur me gurë të çmueshëm e diamante, shtroi tokën me mëndafsh dhe u ul në karrigen e stolisur me diamante e margaritarë për ta pritur delegacionin arab.

Rustemi mendonte se nevoja dhe uria i kishin detyruar muslimanët të dalin jashtë shtëpive të tyre dhe kur do ta shohin arin ndriçues, mëndafshin e galerisë dhe pasurinë e Persisë do të dështojnë zemrat dhe shpirtrat para se të dështojnë shpatat.

Kjo ishte hamendja e Rustemit, edhe pse ajo hamendje konsiderohet si mëkat.

Kur hynë muslimanët në galeri dhe kur e panë arin, mëndafshin, robërit dhe pasuritë tjera që i kishte përgatitur Rustemi, udhëheqësi i delegacionit tha: "Veproni si veproj unë...!" Kështu, hynë në galeri, e shkelën mëndafshin me kuajt e tyre dhe u tallën me ta. Kur arritën te Rustemi, zbritën prej kuajve, i morën jastëkët prej duarve të Rustemit, ministrave e komandantëve, i shqyen dhe i lidhën kuajt në galeri. Edhe pse menduan xhahilat se këta ishin të prapambetur, historia u pëshpëriste: "Kjo është hyrja e fitores dhe fillimi i amshueshmërisë..."

Pastaj Rustemi e pyeti udhëheqësin e delegacionit tonë :

"Çka ju shtyri të dilni nga shtëpitë tuaja e t'i sulmoni shtëpitë tona! Nëse ju shtyri uria, ne do t'ju ushqejmë derisa të ngopeni, nëse ju shtyri lakuriqësia, ne do t'ju veshim dhe nëse ju shtyri varfëria, ne do t'ju pasurojmë!"

Udhëheqësi ynë u përgjigj: "Jo, neve nuk na tronditë në luftë uria e barkut, as varfëria e as veshja. Ju vetë e patë se ne e shkelëm mëndafshin tuaj me kuajt tanë dhe i lidhëm me atë që mburreni ju, gjegjësisht me jastëkët e zbukuruar me flori e argjend. Ne kemi dalur që t'ua transmetojmë mesazhin e të vërtetës, për t'ju nxjerrur prej errësirës në dritë dhe për t'ju çliruar nga idhujtaria..."

Rustemi dhe ata që ishin me të krenoheshin me atë që e kishin tubuar, kurse udhëheqësi ynë krenohej me të vërtetën dhe me besimin.

Pas një kohe u zhvillua beteja në të cilën dështuan armiqtë e pasur nga kuajt e pashaluar, devet e pambuluara, rrobat e vjetra e të këqija dhe shpatat e rëndomta e të mbuluara me leckat!

Fituan ata të cilët i zbukuruan kokat e tyre me krenarinë e Zotit xh.sh. të cilët i mbushën zemrat me premtimin e Zotit dhe i pasuruan shpirtrat me vlerat më fisnike të nderit, lartësisë dhe moralit të lartë...

O bijtë e këtij Ummeti!

Këto dy rrugë janë rrugët e fitores!

Dy mjetet e fitores janë: zjarri dhe drita, hekuri dhe morali, shpata dhe besimi, materia dhe shpirti...

Kujtoni këtë kur të jeni në qendër të betejës dhe kur ende nuk ka fituar armiku i juaj.

- O besimtarë!

Në këtë natë drejtohen lutjet kah Allahu xh.sh. dhe çdokush prej jush e rikujton veten dhe familjen e vet dhe kërkon për të falje e furnizim.

S'është keq që njeriu ta kujtojë veten por është turp ta kujtojë vetëm veten e ta harrojë Ummetin dhe vatanin e vet!

Nëse i drejtoheni Zotit xh.sh. në këtë natë, atëherë drejtohuni me zemër të të penduarve dhe shpirtra të të sinqertëve, pastaj përkujtoni popullin dhe vendin tuaj së bashku me veten tuaj ose para vetes suaj.

Përkujtoni në këtë natë vatanin tuaj të sulmuar, Palestinën e plagosur, ushtrinë tuaj të fuqishme, ardhmërinë e Ummetit dhe vendit tuaj...

Përkujtoni këtë luftë e pastaj kërkon ndihmë prej Allahut xh.sh.!

O ju besimtarë!

Unë ju thërras e ju bëhuni të singertë!

Afrone në zemrat tuaja frikën prej Allahut xh.sh. sepse në këto çaste dyert e qiellit janë të hapura për t'i pranuar lutjet e atyre që frikohen nga Zoti xh.sh. e që pendohen...

O Zot, kërkojmë prej Teje udhëzim, devotshmëri, zemërbutësi dhe pasuri!

O Zot, përmirëso fenë tonë që na mbron, botën ku jetojmë dhe botën ku do të kthehemi! O Zot, bëne jetën tonë të begatshme me mirësi kurse vdekjen qetësi!

O Zot, të lusim që të na kaktosh vendet e të lumturve, nderin e dëshmorëve dhe fitoren kundër armiqve!

O Zot, na bashko në udhëzim, mirësi, famë e amshueshmëri!

O Zot, na mbro nga armiqtë sepse ata janë të dobët para Teje; përçaj dhe dobëso udhëheqësit e tyre që të kacafyten mes vete, zbrite zemërimin Tënd mbi ta dhe na ndihmo ashtu siç ju ndihmon besimtarëve luftëtarë!

O Zot, na dhuro mëshirën Tënde që është udhëzuese për ne! Dhe në fund, i falënderohem Allahut xh.sh. Zotit të botëve!

Dr. Mustafa Sibai

Përmbajtja

HYRJE	2
PJESA E PARË	5
AJETET E AGJËRIMIT	6
HADITHET E AGJËRIMIT	7
A. Vlera e agjërimit:	7
B. Nata e Kadrit	9
C. Prishja e agjërimit të Ramazanit pa arsye	9
D. Vlerat etike të agjëruesit.....	11
Dh. Prishja me harresë.....	11
F. Shpejtimi i Iftarit.....	12
G. Vonimi i Syfyrir	12
Gj. Të ushqyerit e agjëruesit.....	12
H. Namazi i teravive.....	13
HADITHET E BAJRAMIT	14
A. Gdhimi i natës së Bajramit	14
B. Zbukurimi për Bajram	14
C. Ngrënia para namazit.....	14
Ç. Tekbiri në mëngjesin e Bajramit.....	14
D. Namazi i Bajramit.....	15
UDHËZIMET E MUHAMMEDIT A.S. RRETH AGJËRIMIT DHE DY BAJRAMEVE	16
A. Adhurimi dhe bujaria e Muhammedit a.s.	16
B. Iftari i tij para namazit	16
C. Lutja e tij në Iftar.....	16
Ç. Mosagjërimi i tij gjatë udhëtimit	17

D. Në dy festat e Bajramit	17
RREGULLAT E AGJËRIMIT	19
Obligimi i agjërimit të Ramazanit	19
Kushtet e obligimit	19
Parimet e agjërimit.....	20
Çka e prishë agjërimin	20
Aspektet pozitive të agjërimit	21
SADAKATUL-FITRI - DHËNIA E LËMOSHËS	22
A. Tekstet argumentuese.....	22
PJESA E DYTË.....	23
ARDHJA E MUAJIT TË DASHUR	24
RAMAZANI, MUAJI I TË VËRTETËS.....	30
RAMAZANI, MUAJI I FUQISË.....	39
Durimi.....	42
Respektimi	44
Disiplina dhe organizimi.....	45
RAMAZANI, MUAJI I LIRISË.....	47
FILOZOFIA DHE SEKRETET E AGJËRIMIT	56
Sekretet e agjërimit.....	56
RAMAZANI, MUAJI I MIRËBËRJES	60
NDIKIMI I ADHURIMIT (IBADETIT) NË EDUKATËN E POPULLIT	63
INSTITUCIONI I ZEKATIT.....	67
RAMAZANI FLET.....	71
LAMTUMIRA E RAMAZANIT	81
FILOZOFIA E BAJRAMIT	85

PËRKUJTIMI I "ISRASË DHE MI'RAXHIT" NË HISTORINË TONË	91
NATA E MESIT TË MUAJIT "SHA'BAN"	98